Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit

Civil Society for HUMAN RIGHTS

Dhjetor, 2018

European Union Kosovo

KIPRED

GROUP FOR LEGAL AND POLITICAL STUDIES

artpolis

Raport i Politikave

Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës me bazë gjinore në Kosovë: Përfundimi i mosndëshkimit të autorëve të krimit

Autorë: Ariana Qosaj-Mustafa dhe Donjeta Morina

Hulumtimi i kryer nga: Ariana Qosaj-Mustafa, Donjeta Morina, Blend Zyrapi

Hulumtimi i mbështetur nga: Patricia Marie Angus, Njomza Arifi, Rreze Hoxha, Adelina Collaku

© Kosovar Institute for Policy Research and Development, Dhjetor, 2018.

Mendimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorëve të KIPRED, GLPS dhe Artpolis, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve ose Bordit(ve) të tyre. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet ose transmetohet në asnjë formë ose me ndonjë kuptim pa leje. Kontaktoni zyrën administrative të Institutit Kosovar për Hulumtime dhe Zhvillim të Politikave-KIPRED për këto kërkesa.

Kosovar Institute for Policy Research and Development
Major Mehmet Bushi, No. 1
Prishtina 10 000, Kosovo
Website: www.kipred.org
E-mail: info@kipred.org
Tel/fax.: +381 38 542 778

Group for Legal and Political Studies
Rexhep Luci str. 16/1
Prishtina 10 000, Kosovo
Website: www.legalpoliticalstudies.org
E-mail: office@legalpoliticalstudies.org
Tel/fax.: +381 38 234 456

Artpolis – Art and Community Centre
Str. ZenelSalihu Z4 -S3 00022
10 000 Prishtina, Kosova
Website: www.artpolis-ks.com
Tel/fax.: +381 38 221 512

"Ky botim është bërë me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e KIPRED-i dhe nuk pasqyron në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian".

Përmbajtja

Akronime 4
I. Përmbledhje Ekzekutive 5
II. Hyrje 8
a) Qëllimi dhe qasja metodologjike 11
III. Korniza ligjore ndërkombëtare dhe vendore mbi dhunën me bazë gjinore 12
IV. Dhuna në familje si një formë e diskriminimit me bazë gjinore 14
a) Raportimi aktual i dhunës në familje 14
b) Mangësitë e legjislacionit ekzistues 15
c) Mbrojtja e Viktimave të Dhunës në Familje 17
d) Ndjekja dhe shpallja e dënimeve në rastet e dhunës në familje 21
e) Ndërmjetësimi dhe pajtimi në rastet e dhunës në familje 31
f) Strehimoret për Viktima të Dhunës në Familje 33
V. Dhuna seksuale si formë e dhunës në bazë gjinore 36
a) Mangësitë në legjislacionin ekzistues 37
c) Raportimi i rasteve lidhur me Dhunën Seksuale 40
d) Ndjekja dhe dënimi i rasteve të dhunimit 42
V. Dhuna ndaj personave LGBT 46
a) Problemet me ligjet ekzistuese 46
b) Problemet me implementimin e ligjeve ekzistuese 49
c) Reagimi i Drejtesisë 51
VIII. Konkludime dhe rekomandime 53
IX. Bibliografia 57

Akronime

BE	Bashkimit Evropian
DhBGJ	Dhuna në Baza Gjinore
EULEX	Misioni I Bashkimit Evropian Per Sundimin e Ligjit ne Kosove
KEGjFdG	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
LBGJ	Ligji për Barazi Gjinore
LGBT	Lezbike, Biseksual, dhe Transgjinor
LMDhF	Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NjHdHF	Njësitë për Hetimin e Dhunës në Familje
OShC	Organizata e Shoqërisë Civile
PSV	Procedura Standarde të Veprimit
QDhS	Qendrave për Dhunime Seksuale
QPS	Qendrat për Punë Sociale
QRS	Qendrave Referuese Seksuale
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
UM	Urdhrat e Mbrojtjes
UME	Urdhër Mbrojtës Emergjent
UMEP	Urdhër Mbrojtës Emergjent i Përkohshëm

I. Përmbledhje Ekzekutive

Dhuna me bazë gjinore mbetet e përhapur si në Kosovë ashtu edhe në tërë botën. Ndërsa normat e incidenteve mbeten alarmante, duke ndikuar në një në çdo tre gra në nivel global, një reagim adekuate ndaj kësaj dhune mbetet e kufizuar në Kosovë. Ky raport i politikave synon të ngushtojë hendekun ekzistues të njohurive duke ofruar një analizë konkrete të ligjeve dhe politikave ekzistuese dhe zbatimin praktik të tyre. Konkretisht, hulumtimi fokusohet në qasjen e viktimave të dhunës në familje, sulmit seksual, ngacmimeve seksuale dhekrimeve kundër personave Gej, Lezbike, Biseksual, dhe Transgjinor (LGBT) brenda proceseve ekzistuese të drejtësisë penale, duke përfshirë analizën e mbështetjes institucionale dhe mbështetjes së duhur ligjore.

Vetëm sipas Ligjit të Kosovës për Barazi Gjinore dhuna me bazë gjinore konsiderohet si formë diskriminimi (neni 4.2 i ligjit). Megjithatë, Kosova ende nuk ka ndonjë përkufizim të dhunës me bazë gjinore në procedurat penale dhe civile. Përkundër kornizës ligjore, e cila mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, ndikon ndjekjen efektive dhe dënimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Dhe, edhe pse përkufizimet për dhunim, vrasje, veprime kundër partnerëve të brendshëm dhe disa krime të tjera të dhunës në baza gjinore ekzistojnë në legjislacion, hetimi dhe ndjekja e krimeve të tilla vazhdojnë të karakterizohen me shkallë të ulët të dënimit.

Mosndëshkimi i vazhdueshëm për autorët e krimit nga ana e sistemit të drejtësisë penale ka bërë që të drejtat e garantuara përmes ligjeve të jenë të pabarabarta për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Aktualisht, në legjislacionin e Kosovës mungon një përkufizim i dhunës me bazë gjinore në përputhje me përkufizimin e ofruar në Konventën e Stambollit. Konventa e Stambollit ende nuk është pjesë e Kushtetutës së Kosovës, por ka pasur thirrje për të ndryshuar Kushtetutën me qëllim që të përfshihet në të edhe Konventa e Stambollit në kuadër të nenit 22 të Kushtetutës.

Sigurimi i qasjes efektive dhe me kohë në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore është një hap i rëndësishëm drejt integrimit të Kosovës në BE. Praktika ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që ka të bëjë me dhunën me bazë gjinore, megjithëse e detyrueshme për Kosovën, përdoret rrallë nga gjyqësori i Kosovës. Kështu, një sfidë e vazhdueshme mbetet përdorimi i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga gjyqësori i Kosovës.

Në krahasim me numrin aktual të incidenteve, dhuna në familje në Kosovë mbetet pak e raportuar. Faktorë të ndryshëm vazhdojnë të çojnë në reagime joadekuate ndaj rasteve të dhunës në familje. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes për viktimat që kërkojnë mbrojtje është përmirësuar në vitet e fundit; megjithatë, policia dështojnë të bëjnë vlerësime të rregullta dhe të vlefshme për rrezikun gjatë edhe pas lëshimit të urdhrave të mbrojtjes. Mungesa e vlerësimit të rrezikut për abuzimet sistematike në rastet e dhunës në familje ka çuar në pasoja tragjike si në rastin e vrasjes së Valbona Marku-Nrecajt dhe vajzës së saj 9-vjeçare në gusht të vitit 2018.

Reagimi i gjyqësorit ndaj akteve të dhunës në familje mbetet i dobët. Norma e rasteve të hedhura poshtë të dhunës në familje mbetet e lartë, pasi gjatë vitit 2017 ishin më shumë se gjysma e të gjitha kallëzimeve penale të lidhura me rastet e dhunës në familje (51.5%) që ishin hedhur poshtë nga gjykatat e Kosovës. Për më tepër, gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, u hodhën poshtë gjithsej 15.1% raste. Për periudhën e monitoruar për 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve kanë marrë vendime të fajësisë. Kjo përgjigje e ngadaltë nga sistemi i drejtësisë penale ndaj rasteve të dhunës në familje ka çuar në shfaqjen e përgjithshme të mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje. Për më tepër, viktima që fajësohet dhe pajtimi i viktimës me kryerësin mbetet e zakonshme në mesin e të gjitha institucioneve të monitoruara, shpesh të justifikuara me qëllim të "shpëtimit" të familjes tradicionale.

Kodi Penal i tanishëm vazhdon të ketë mangësi të një përkufizimi specifik të dhunimit martesor dhe ngacmimit seksual, duke çuar shpesh në ndjekjen dhe dënimin joadekuat penal të krimeve të tilla. Aktualisht nuk ka procedura standarde të veprimit për krimet që lidhen me dhunën seksuale, gjë që çon shpesh në një reagim të pakoordinuar të institucioneve përkatëse. Në rastet kur viktimat nuk duan të raportojnë dhunimin menjëherë, nuk ka asnjë mjet për të ruajtur provat mjeko-ligjore pasi që Kosova nuk ka sisteme të specializuara mbështetëse për viktimat e dhunimit, siç janë Qendrat e Krizave të Dhunimit dhe Qendrat e Referimit Seksual. Më tej, qëndrimet për fajësimin e viktimave janë të zakonshme në të gjitha institucionet gjyqësore. Në disa raste, gjyqtarët kanë komentuar mënyrën se si ishte veshur viktima ose kanë arsyetuar dhunimin mbi premisën se viktimat kishin dalë jashtë vetëm gjatë natës. Meqenëse ngacmimi seksual nuk është i përkufizuar në mënyrë specifike në Kodin Penal, kjo situatë ka bërë që institucione të ndryshme të drejtësisë penale të mos mbajnë të dhëna për rastet e ngacmimit seksual. Meqenëse Kodi Penal aktualisht është duke u ndryshuar, ka nisma të udhëhequra nga shoqëria civile dhe aktivistët për të përfshirë përkufizimin specifik të ngacmimit seksual dhe dhunës në familje brenda Kodit të ri Penal. Më 6 nëntor 2018, grupi i punës i Komisionit për Legjislacion i Kuvendit të Kosovës shqyrtoi draftin e Kodit Penal dhe ka punuar në përpunimin

e rekomandimeve nga shoqëria civile duke përfshirë në mënyrë specifike përkufizimin e dhunës në familje dhe ngacmimeve seksuale brenda draftit aktual.

Reagimi përgjithësisht i dobët i sistemit të drejtësisë penale, mungesa e vetëdijes së viktimave për raportimin në kohë të krimeve të dhunimit dhe besimi i ulët në sistemin e drejtësisë ka çuar në raportimin e ulët të rasteve të dhunimit në Kosovë. Rrjedhimisht, gjatë periudhës së monitoruar 2015-2018 ka pasur vetëm 15 raste të raportuara të krimit të dhunimit në Kosovë.

Për më tepër, ekzistojnë edhe boshllëqe ligjore që pengojnë personat e komunitetit LGBT që të gëzojnë të drejtat e tyre të garantuara me ligje të veçanta si Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe dispozitat e përgjithshme të parapara me Ligjin mbi Gjendjen Civile. Duke përcaktuar ndryshe "gjininë", pabarazitë ndërmjet "ligjeve kryesore" dhe "ligjeve të veçanta" që garantojnë mbrojtjen e identitetit LGBT në Kosovë kanë shkaktuar vështirësi për burrat dhe gratë transgjinor në drejtim të përafrimit të dokumenteve të identifikimit me identitetin e tyre gjinor.

Aktualisht ka vetëm një rast brenda gjykatave të Kosovës për dhunën e raportuar kundër personave LGBT. Kjo mungesë e rasteve e bën të vështirë monitorimin e reagimit të sistemit gjyqësor ndaj personave LGBT. Në fakt është një rast i vetëm me aktgjykim të formës së prerë ku pranohet orientimi seksual i viktimave si një rrethanë rënduese dhe jo si një vepër penale me motiv urrejtjeje. Baza e të dhënave ekzistuese institucionale e hartuar nga Policia e Kosovës dhe Mbrojtësit e Viktimave nuk ndjekin veprat penale të urrejtjes kundër personave LGBT.

II. Hyrje

Shpeshtësia e dhunës me bazë gjinore ndaj grave në Kosovë mund të karakterizohet si pandemike. Vlerësohet se një në çdo tre gra ka përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri dhe se një në çdo dhjetë gra kanë përjetuar marrëdhënie të dhunshme ose akte të tjera seksuale në një moment të caktuar të jetës së tyre.[1] Dhuna me bazë gjinore kundër grave është e përkufizuar si dhunë që i ndikon gratë në mënyrë jo proporcionale, apo dhunë që drejtohet kundër një gruaje për faktin e vetëm se ajo është një grua.[2] Llojet e dhunës që përfshihen në këtë përkufizim janë: dhuna seksuale dhe dhunimi, krimet e "nderit", gjymtimi gjenital, dhuna në familje, ngacmimi seksual dhe martesa e detyruar.[3] Në përgjithësi, këto forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore konsiderohen si mjete me të cilat gratë janë në vartësi sociale, politike dhe ekonomike.[4] Megjithatë, është e rëndësishme të kihet parasysh se termi nuk aplikohet ekskluzivisht vetëm për gratë. Edhe pse ka më pak të ngjarë, termi "dhunë me bazë gjinore" përfshin gjithashtu dhunën e përdorur kundër burrave. Për shembull, dhuna seksuale e ushtruar kundër njerëzve gjatë konflikteve, dhunës seksuale në burg ose dhuna e kryer kundër djemve për t'i nxitur ata të "sillen si burra."[5] Në mënyrë të ngjashme, ky term mund të përcaktojë gjithashtu edhe dhunën e ushtruar kundër personave trasngjinorë për shkak të identitetit të tyre gjinor.[6]

Mbizotërimi i dhunës me bazë gjinore mbetet alarmant në Kosovë. Gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar, ka pasur një rritje në numrin e raportuar të rasteve të vrasjeve që kanë rezultuar nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore.[7] Në vitin 2015, 68% e grave kanë raportuar se kanë përjetuar një formë të dhunës në familje në jetën e tyre.[8] Në vitin 2017, ka pasur 1,299 raste të raportuara

---

[1] UN Women, "Fakte dhe Shifra: Përfundimi i dhunës kundër grave një pandemi në formate ndryshme ", faqja e qasur më 22.7.2018 at: http://www.unwomen.org/en/what-we-do/ending-violence-against-women/facts-and-figures

[2] Këshilli i Evropës, Konventa për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Neni 3-D, 2011, at: https://rm.coe.int/168046031c

[3] Ibid. Preambula

[4] Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Rekomandimi i Përgjithshëm nr.35 për dhunën me bazë gjinore ndaj grave, duke përditësuar rekomandimin e përgjithshëm Nr. 19, Neni 10 2017, at: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_35_8267_E.pdf

[5] Rrjeti i Grave të Kosovës, Nga fjalët në veprim: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës në baza gjinore në Kosovë, 2017, at: www.womensnetwork.org/documents/20180312142859762.pdf

[6] Lombardi et al. Gender Violence: Transgender Experiences with Violence and Discrimination, Volume 42, Issue 1, 2002, at: https://www.tandfonline.com/doi/abs/10.1300/J082v42n01_05

[7] Disa prej emrave të raportuar në media janë: ZejnepeBytyqi, Donjeta Pajaziti, ValbonaMarku-Nrecaj dhe vajza e saj Klara Nrecaj, Diana Kastrati, Antigona Morina, Miradije Hetemi, Dafina Zhubi, Igballe Llalloshi, Sevdije Berisha. Shih për shembull https://www.koha.net/arberi/74567/rasti-i-vdekjes-se-antigona-morines-tri-dite-pas-marteses-skishte-shkuar-fare-ne-apel./; https://www.koha.net/kronike/119602/aktakuze-per-vrasesin-e-bashkeshortes-dhe-vajzes-ne-gjakove/ etj.

[8] Rrjeti i Grave të Kosovës, Mjaft më me arsyetime - Një analizë e qëndrimeve, incidencës dhe përgjigjesisë institucionale ndaj dhunës në familje në Kosovë, 2015, në: **https://www.womensnetwork.org/documents/20151124105025622.pdf**

të dhunë në familje në polici.[9]Dhunimi, sulmet seksuale dhe format e tjera të dhunës me bazë gjinore vazhdojnë të mbizotërojnë, por nuk janë mjaftueshëm të raportuara. Për më tepër, vlerësohet se 64% e grave janë ngacmuar seksualisht gjatë jetës së tyre.[10]

Të dhënat institucionale ekzistuese nuk janë të mjaftueshme për të monitoruar mbizotërimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, sepse nuk ekziston një mekanizëm institucional për të përcjellë rastet e hetuara, ndjekur penalisht dhe gjykuar nga gjykatat (duke përfshirë ndjekjen e praktikave të dënimit brenda gjykatave). Gjithashtu nuk ka të dhëna të ndara mbi krimet e dhunës në baza gjinore që mund të përdoren për të identifikuar se sa vrasje në Kosovë janë kryer si rezultat i marrëdhënieve familjare. Raporte të tjera tregojnë se dhuna me bazë gjinore mbetet e përhapur dhe nuk adresohet në mënyrë të mjaftueshme nga institucionet e drejtësisë.

Për shembull, Raporti i BE për Kosovën i vitit 2018 thekson koordinimin e dobët midis institucioneve të drejtësisë për sa i përket rasteve të dhunës me bazë gjinore.[11] Ndër të gjeturat e tjera, raporti identifikon nevojën për trajnime të mëtejshme të specializuara në lidhje me krimet e dhunës me baza gjinore, përfshirë ngacmimet seksuale.[12] Prandaj BE-ja rekomandon që institucionet në Kosovë duhet të përcaktojnë në mënyrë të përshtatshme ngacmimin seksual dhe dhunën në familje në përputhje me Kodin Penal.[13] Vullneti institucional për të zbatuar strategjitë relevante të dhunës në familje dhe ligjet përkatëse mbetet e një rëndësie shumë të madhe.[14] Prandaj, reagimi shtetëror për të ofruar qasje dhe drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore mbeten të një rëndësie shumë të madhe për të ardhmen e Kosovës dhe procesin e saj të integrimit në B.[15]

Sistemi i drejtësisë i Kosovës vazhdon të përballet me sfida sistematike, duke bërë që viktimat e dhunës në baza gjinore të jenë më të ndjeshme ndaj ofrimit të drejtësisë joefektive. Shumë prej këtyre sfidave rezultojnë nga fakti se Kosova është ende në fazat e fillimit të zhvillimit të një sistemi gjyqësor funksional.[16] Tanimë për më shumë se një dekadë, gjykatat e Kosovës janë ballafaquar me një grumbull të lëndëve të pazgjidhura gjë që e ka vonuar drejtësinë për viktimat

[9]Shoqëria Civile për të Drejtat e Njeriut, Faqja e internetit e qasur në gusht 2018, at: http://www.cshr-ks.org/en/kosovo-police/?v=2017&id=1
[10]Rrjeti i Grave të Kosovës, Dhuna Seksuale në Kosovë, 2016, at: https://www.womensnetwork.org/documents/20160223185243349.pdf
[11]Komisioni Evropian, Dokument i Stafit Punues të Komisionit, Kosovë* Raport 2018, at: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf
[12] Ibid. Faqe 16
[13]Supra Note 11, f. 25.
[14]Supra Note 11.
[15] Programi Kombëtar i Kosovës për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (2017-2021) me BE, faqe 246.
[16]Supra Note 11.

dhe palët e tjera të përfshira.[17] Për më tepër korrupsioni në nivel të lartë mbetet shumë i zgjeruar dhe kjo shpije drejt mos efikasitetit të përgjithshëm të sistemit të drejtësisë.[18] Edhe pse është bërë progres në luftën kundër korrupsionit gjatë viteve të fundit, ende ka nevojë për masa gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit.[19] Kosova, së bashku me vendet e tjera në rajonin e Ballkanit janë identifikuar si "shtet i kapur"[20] duke përfshirë këtu edhe mungesën e një sistemi të pavarur dhe efikas të gjyqësorit.[21] Për më tepër, gjyqësori mbetet me prirje të jetë i ndikuar nga politika dhe joefikasitetit, duke ndikuar më tej në cilësinë e sistemit të drejtësisë.[22]

Situata është përkeqësuar më tej për shkak të mungesës së besimit të qytetarëve të Kosovës në sistemin gjyqësor. Një sondazh i kryer në vitin 2016 arriti në përfundimin se vetëm 5% e kosovarëve janë në përgjithësi të kënaqur me policinë, prokuroritë, gjykatat, EULEX-in dhe Qeverinë.[23] Më tej, në vitin 2016 një studim përfaqësues me 1097 anketues në tërë Kosovën ka treguar se më shumë se një e treta e të gjithë të anketuarve perceptojnë se gjykatat e Kosovës (34.28%) ose prokuroria (31.09%) më së shumti kërkojnë ose pranojnë ryshfet.[24] Ndryshe, besimi në shërbimin e Policisë së Kosovës është më i lartë.[25] Përkeqësimi ekzistues i sistemit të sundimit të ligjit mund të lejojë ngritjen e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, duke u pasuar nga një kulturë e mosndëshkimit, ku autorët e krimit nuk përballen me pasoja shoqërore ose ligjore.[26] Prandaj, ky raport politikash synon të analizojë lidhjen ndërmjet ligjeve dhe ofrimit praktik të drejtësisë për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Kosovë për shkak të veçorive të krimeve të dhunës me bazë gjinore dhe ndjeshmërisë gjinore të krimeve. Kjo bëhet duke shfrytëzuar kërkesat e standardeve të fundit ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për ofrimin efektiv dhe në

---

[17] Ibid.
[18] Departamenti i Shtetit Amerikan, Raporti për të Drejtat e Njeriut 2016, 2016, në: https://www.state.gov/documents/organization/265648.pdf
[19]Komisioni Evropian "Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së, 2018, faqe 16, në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf
[20] Komunikimi i referohet elementeve të kapjes së shtetit si lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisë dhe administratës, si dhe një ngatërrim të fortë të interesave publike dhe private. Shikoni faqen 3 të Komisionit Evropian "Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së, 2018, faqe 16, në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf
[21] Ibid
[22] Ibid.
[23] Grupi për Studime Ligjore dhe Politike, "Kënaqësia e qytetarëve kosovarë me sundimin e ligjit: një studim empirik, 2016, at: www.legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2017/02/Kosovar-Citizens-Satisfaction-with-the-Rule-of-Law-Institutions-An-Empirical-Study.pdf
[24]Ndryshe, 57.97% e të anketuarve kanë thënë se zyrtarët e EULEX-it asnjëherë apo thuajse asnjëherë nuk kanë pranuar apo kërkuar ryshfet. Ibid.
[25] Një studim i fundit nga Qendra e Kosovës për Studimet e Sigurisë tregon se 61% e qytetarëve të Kosovës i besojnë Policisë së Kosovës. Për më shumë shih Qendrën e Kosovës për Studime të Sigurisë, Barometri i Sigurisë së Kosovës: Edicioni i Shtatë, 2018, në: www.qkss.org/repository/docs/KOSOVO_SECURITY_BAROMETER_7__ENGLISH_FINAL_891249.pdf
[26] Komisioni për Eliminimin e Diskriminimit kundër Grave, Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave, duke përditësuar rekomandimin e përgjithshëm Nr.19, 2017, në: https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/CEDAW_C_GC_35_8267_E.pdf

kohë të drejtësisë për viktimat e dhunës me bazë gjinore, siç përcaktohet në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (në tekstin e mëtejmë: Konventa e Stambollit).

a) Qëllimi dhe qasja metodologjike

Raporti shqyrton ligjet ekzistuese dhe politikat për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Kosovë, si dhe shpërndarjen e tyre në praktikë në mënyrë efektive dhe në kohë. Duke pasur parasysh se ka pak hulumtime për qasjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore në drejtësi, raporti është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të KIPRED-it, Grupit për Studime Ligjore dhe Politike dhe Artpolisit në kuadër të projektit të financuar nga BE për "Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut nëpërmjet një shoqërie civile aktive".

Hulumtimi ka identifikuar disa sfida me të cilat përballen viktimat e dhunës me bazë gjinore, që kanë të bëjnë me legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij. Rastet e dhunës në baza gjinore të analizuara në kuadër të raportit përqendrohen në rastet e dhunës në familje, sulmeve dhe dhunimeve seksuale, ngacmimit seksual dhe krimit ndaj personave LGBT. Përderisa përkufizimi ndërkombëtar i dhunës me bazë gjinore është më i gjerë, raporti e përqendron analizën e tij mbi përkufizimet e mësipërme për shkak të këmbënguljes së paraqitjes së këtyre rasteve. Për më tepër, në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, raporti propozon zgjidhje dhe rekomandime konkrete për politikat për të përmirësuar qasjen në drejtësi për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Duke matur standardet vendore kundrejt standardeve të përcaktuara nga Konventa e Stambollit, raporti analizon legjislacionin ekzistues mbi dhunën me bazë gjinore dhe nivelin e zbatimit të tyre. Metodologjia e përdorur përfshinë disa metoda të analizës cilësore. Hulumtimi përdorë hulumtime të nivelit të lartë, të mbledhura nga shqyrtimi dhe analizimi i raporteve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare të disponueshme në këtë fushë. Ajo gjithashtu përfshin një analizë ligjore të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe ligjeve të saj të zbatueshme. Duke analizuar mangësitë në kuadër të zbatimit të ligjit, shërbimit prokurorial dhe atij gjyqësor, raporti jep katër shembuj për të ilustruar mangësitë aktuale me të cilat ballafaqohen viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe gjithashtu të komunitetit LGBTI në qasjen në drejtësi. Janë bërë gjithashtu edhe disa intervista me institucione të ndryshme,[27]përfshirë midis akterëve të tjerë edhe Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Avokatin e Viktimave, Policinë e Kosovës, qendrat e strehimit dhe aktivistet e grave. Periudha raportuese e këtij hulumtimi mbulon të dhëna, ndryshime në politika, ligje, dhe institucione deri me 15 Nëntor 2018.

[27] Lista e plotë e intervistave mund të ofrohet me kërkesë.

III. Korniza ligjore ndërkombëtare dhe vendore mbi dhunën me bazë gjinore

Dhuna me bazë gjinore është shkelje e të drejtave të njeriut. Në vitin 1992, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (KEDKG), veçanërisht, Rekomandimi Nr. 19, ka pranuar dhunën me bazë gjinore si një formë të diskriminimit që e pengon barazinë e grave.[28] KEDKG thekson më tej se shtetet janë përgjegjëse për parandalimin e dhunës me bazë gjinore, si dhe hetimin dhe ndëshkimin e këtyre veprave.[29] Sipas KEDKG, shtetet janë përgjegjëse për gabimet dhe aktet e dhunës me bazë gjinore brenda territorit të tyre, veçanërisht nëse ato përfshijnë lëshime nga ana e gjyqësorit, legjislativit dhe ekzekutivit.[30] Ajo që është më e rëndësishme është se Konventa thekson se të gjitha shtetet duhet të kenë një sistem ligjor efektiv dhe të qasshëm që adreson të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.[31] KEDKG është shumë mirë e përfshirë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës përmes nenit 22 dhe dispozitat e tij e zëvendësojnë legjislacionin vendor.[32]

Konventa e Stambollit është instrumenti më i fundit ndërkombëtar i zhvilluar i cili trajton dhunën me bazë gjinore në një qasje gjithëpërfshirëse.[33] Qëllimi i përgjithshëm i Konventës është që të ketë qasje gjithëpërfshirëse kombëtare në luftën kundër të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore, dispozita për masat parandaluese në vend dhe mbrojtje dhe mbështetje për viktimat. Gjithashtu, ajo thekson rëndësinë e përfundimit të mosndëshkimit për autorët si një fenomen global, i cili kërkon ndjekjen e shpejtë dhe efektive të autorëve të krimit.[34] Konventa trefishohet si një traktat ligjor penal, traktat për të drejtat e njeriut dhe instrument për rritjen e barazisë gjinore.[35] Ajo në mënyrë efektive penalizon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë format e ndryshme të dhunës, qofshin ato psikologjike apo fizike, dhunime dhe dhunë seksuale, përcjelljen/përndjekjen e viktimës, gjymtimin gjenital femëror, sterilizimin e

---

[28] Komisioni për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, rekomandimi i përgjithshëm nr. 19, 2011, at: https://d2t1lspzrjtif2.cloudfront.net/wp-content/uploads/ARTICLES-19.pdf
[29] Ibid. neni 9
[30] Supra Note 28. neni 22
[31] Ibid.
[32]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008, at: www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Constitution1Kosovo.pdf
[33] Supra Note 2.
[34] Ibid. Neni 49
[35]Krol et al për Këshillin e Evropës, Hartimi i shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës kundër grave në Kosovë, faqe 12, 2017

detyruar dhe abortin ose martesën e detyruar.[36] Përderisa Konventa e Stambollit nuk është ende pjesë e Kushtetutës së Kosovës, ka pasur thirrje për të ndryshuar Kushtetutën për të përfshirë Konventën e Stambollit në kuadër të nenit 22. Në mënyrë të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar ndryshime kushtetuese me qëllim që Konventa e Stambollit të bëhet e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në legjislacionin e Kosovës.[37]

Në nivel vendor, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton barazinë gjinore si vlerë themelore.[38] Vetëm në bazë të Ligjit për Barazi Gjinore, dhuna me bazë gjinore njihet si një formë e diskriminimit.[39] Megjithatë, Kosova akoma ka mungesë të një përkufizimi të dhunës me bazë gjinore brenda procedurave të saj penale dhe civile. Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje ofron një përkufizim të dhunës në familje në procedurat civile duke krijuar bazën për lëshimin e masave të mbrojtjes me anë të urdhrave mbrojtës.[40] Kjo qasje ka bërë që në mënyrë efektive në procedurat civile të shfrytëzohen më tepër dispozitat e parapara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje më shpesh sesa procedurat penale. Kjo ndikon që viktimat të mbeten të brishta dhe t'i lën autorët e veprave të dhunës në familje imun prej ndjekjes penale. Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes dhe përdorimi i procedurave civile vetëm në gjykata është perceptuar si zëvendësim i ndjekjes penale të autorëve të krimit.[41]

Format e tjera të dhunës në familje dhe disa forma të dhunës me bazë gjinore janë kriminalizuar brenda Kodit Penal të Kosovës, përfshirë këtu dhunimin, sulmin seksual dhe abuzimin.[42] Pavarësisht se "ngacmimi" është përfshirë në Kodin Penal, nuk ka përkufizim specifik të ngacmimit seksual. Megjithatë, ekziston një nismë për të shtuar dy definicione të dhunës në

---

[36]Supra Note 2, Kap. V

[37]Avokati i Popullit, Raport Vjetor 2016, faqe 54, në: www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2016__ANG__no16_me_kopertine_per_web_338158.pdf

[38]Supra Note 32. neni 7.2

[39]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 05/L-020 mbi Barazinë Gjinore, 2015, at: www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf neni 4.2

[40] Përkufizimi i Dhunës në Familje në Ligj është mjaft i gjerë dhe përfshin aktet e dhunës në familje si veprime dhe/ose lëshime të kryera kundër një personi brenda një marrëdhënieje familjare (Neni 2.1.2) Këto veprime përfshijnë dhunën fizike dhe psikologjike dhe kërcënimet e tyre, duke shkaktuar frikë, sulme fizike, fyerje dhe vepra penale, sjellje nënçmuese, dhunim martesor dhe keqtrajtim seksual, duke kufizuar lirinë e lëvizjes, dëmtimin e pronës dhe kërcënimin e tij, duke e detyruar hyrjen ose largimin nga vendbanimi dhe rrëmbimi (Neni 2.1.1) Lëshimi i urdhrave të mbrojtjes, me qëllim parandalimin e veprimeve të dhunës në familje. Tre lloje të OM janë të përshkruara në ligj: Urdhrat e Mbrojtjes (UM), Urdhrat e Mbrojtjes së Jashtëzakonshme (UMJ), dhe Urdhrat e Mbrojtjes së Përkohshme të Emergjencave (UMPE).

[41]Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, Raporti i Vlerësimit i Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014, at: https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Ambasada_Raporti%20anglisht.pdf

[42]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Kodi Penal i Republikës së Kosovës Nr. 04 / L-082, Kreu XX "Veprat penale kundër integritetit seksual", 2012, në: www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf

familje dhe ngacmimeve seksuale në Kodin e ri Penal që po zhvillohet aktualisht.[43] Aktualisht, ende nuk ka ndonjë përkufizim të plotë që është në përputhje me përkufizimin e ofruar në Konventën e Stambollit.

Përkundër kornizës ligjore që mbulon disa akte të dhunës me bazë gjinore, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës dhe holistik të dhunës me bazë gjinore, siç është ofruar në Konventën e Stambollit, ndikon edhe në ndjekjen penale efektive dhe dënimin e dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Edhe pse veprimet e dhunimit, vrasjes, dhunës në familje dhe dhunës tjetër në baza gjinore ekzistojnë në legjislacion, hetimi dhe ndjekja penale e krimeve me bazë gjinore vazhdon të karakterizohet me shkallë të ulët të dënimit. Seksioni në vijim analizon format më të shprehura të dhunës me bazë gjinore në Kosovë, normat e tyre të paraqitjes dhe raportimin, sfidat pasuese në lidhje me ligjet dhe politikat ekzistuese si dhe reagimin institucional ndaj tyre.

IV. Dhuna në familje si një formë e diskriminimit me bazë gjinore

a) Raportimi aktual i dhunës në familje

Në vitin 2017, kanë ekzistuar gjithsej 1,299 raste të dhunës në familje të raportuara pranë Policisë së Kosovës,[44] duke e shndërruar kështu dhunën në familje si formën më të shprehur dhe më të raportuar të dhunës me bazë gjinore në Kosovë. Nga numri i përgjithshëm, 76.21% e rasteve të raportuara janë nga gratë dhe vajzat, dhe rastet e mbetura janë të raportuara nga meshkujt. Kjo i bën gratë si viktimat më të prekura të dhunës në familje. Nga ky numër, gjithsej 129 raste të raportuara janë nga individë mbi moshën 65 vjeçare, gjë që tregon se të moshuarit janë gjithashtu në rrezik nga dhuna në familje (shih tabelën 1). Megjithatë, sondazhet ekzistuese përfundojnë se incidentet aktuale janë shumë më të larta dhe se shumë raste mbeten të pa raportuara. Incidentet aktuale arrijnë deri në 68% për gratë[45] por mbesin të pa raportuara për shkak të perceptimit të vazhdueshëm që dhuna në familje është çështje private nga frika për stigmatizimin dhe turpërimin dhe besim përgjithësisht i ulët ndaj institucioneve të sundimit të ligjit.[46]

[43]Zyra e Kryeministrit të Kosovës "Programi Legjislativ 2018", 2018, në: www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2018,.pdf
[44] Website i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut, "Mekanizmi Ndjekës", Përditësuar Së Fundmi Gusht 2018, në: http://www.cshr-ks.org/en/
[45] Supra Note 8.
[46] Ibid, faqe 55

Tabela 1 Rastet e Dhunës në Familje të Raportuara në Policinë e Kosovës (Të dhënat e ofruara nga Policia e Kosovës)				
Viti	2015	2016	2017	Janar-Korrik 2018
Te raportuara nga gratë	862	992	990	515
Te raportuara nga burrat	202	255	309	123
Mbi moshën 65 vjeq	N/A	N/A	129	59
Shqiptarë	879	1051	1045	523
Serb	88	90	87	40
Rom	26	20	40	12
Ashkali	26	34	36	16
Egjiptian	11	6	31	7
Goran	14	12	8	3
Turq	7	12	4	11
Boshnjak	10	16	35	18
Të tjerë	3	6	13	8

Pjesa më poshtë përfshin studime të hollësishme të rasteve, duke përfshirë një analizë të reagimit ekzistues institucional në rastet e dhunës në familje në mënyrë specifike.

b) Mangësitë e legjislacionit ekzistues

Kodi Penal i Kosovës nuk e përcakton dhunën në familje si vepër penale. Megjithatë, disa veprime të dhunës në familje janë kriminalizuar sipas Kodit Penal, edhe në mungesë të një përkufizimi specifik.[47] Shumë të intervistuar, përfshirë edhe prokurorë, kanë deklaruar se mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës i dhunës në familje ua bën më të vështirë institucioneve që të reagojnë menjëherë dhe të ndjekin penalisht këto vepra.[48] Sipas Konventës së Stambollit, shteteve u kërkohet të kriminalizojnë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën fizike, përcjelljen e viktimës, dhunën psikologjike dhe dhunën seksuale, e cila përfshin dhunimin dhe ngacmimin seksual.[49] Në të gjithë tekstin, konventa në mënyrë specifike njeh natyrën gjinore të dhunës ndaj grave, si "të drejtuar kundër një gruaje vetëm për shkak se ajo është një grua."[50] Kjo dhunë dallon prej llojeve të tjera të dhunës, pasi që gjinia e viktimës është një motiv parësor për aktet e dhunës që ndodhin dhe është rezultat i marrëdhënieve të

[47]Sipas Kodit Penal, krime të tilla si dhunimi, sulmi seksual, lëndimet e lehta dhe të rënda trupore dënohen ex officio kur ndodhin në një marrëdhënie familjare
[48] KIPRED intervistë me Prokurorë të Kosovës, gusht dhe shtator 2018
[49] Supra Note 2, nenet 33 to 41
[50] Këshilli i Evropës, Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës mbi Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, faqe 43, 2011, në: https://rm.coe.int/16800d383a

pabarabarta të pushtetit të përjetuar nga dallimet e perceptuara midis grave dhe burrave, që shpesh çojnë në statusin e varësisë së grave në jetën private dhe publike. Një dhunë e tillë është gjithashtu e rrënjosur në strukturat shoqërore dhe kulturore, si dhe normat dhe vlerat e shoqërive, dhe si e tillë përkeqësohet më tej për shkak të mohimit dhe/ose heshtjes kulturore.[51] Një qasje specifike e pranimit të termit të dhunës me bazë gjinore kundër grave, në veçanti ashtu siç është përkufizuar në Konventën e Stambollit, mungon në qasjen aktuale ligjore në Kosovë.

Legjislacioni ekzistues në qasjen e tij është neutral ndaj gjinisë. Për shembull, Ligji i Kosovës për Barazinë Gjinore dhe Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, nuk pranojnë që dhuna në familje dhe dhuna në baza gjinore ndikojnë në mënyrë jo proporcionale tek gratë. Në anën tjetër, një kuptim gjinor i dhunës kundër grave është një kërkesë specifike e Konventës së Stambollit.[52] Qasja neutrale e Kosovës ndaj gjinisë ka kontribuar në krijimin e mëtejmë të ligjeve të verbra ndaj çështjes së pabarazisë gjinore. Për shembull, Ligji i Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është kritikuar sepse i kushton shumë rëndësi autorëve të krimit dhe nevojave të tyre për rehabilitim,[53] në kundërshtim me rëndësinë që u kushton shërbimeve mbështetëse të viktimave apo viktimave të mundshme. Qëndrimi në kuadër të ligjit aktual sugjeron se alkoolizmi dhe abuzimi me drogat janë shkaqet kryesore të dhunës në familje, duke mos njohur natyrën gjinore të dhunës ndaj grave.[54]

Më tej, edhe pse Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës thekson se liritë themelore dhe të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në përputhje me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kjo praktikë thuajse nuk ekziston fare.[55] Për më tepër, neni 22 i KEDKG e zëvendëson legjislacion vendor. Deri më tani, gjykatat e Kosovës kanë përdorur rrallë jurisprudencën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në praktikën e tyre gjyqësore. Vetëm në vrasjen e Diana Kastratit, Gjykata Kushtetuese e Kosovës citoi shkeljen e shtetit të Kosovës për të mbrojtur jetën e saj, në përputhje me nenin 2 të KEDNJ-së.[56] Gjykata Kushtetuese e Kosovës paraqiti jurisprudencën e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në vendimin e cituar "Gëzim dhe

[51] Ibid. Faqe 8.
[52] Ibid. Preamble.
[53] Supra Note 35. faqe 12
[54]ShihQeverinë e Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të kryerësve të dhunës në familje, 2012, në: gbvaor.net/wp-content/uploads/2013/02/AI- imple-Law-aginst-DV-trajtimi psikosocial-i-kryerësit-Eng-Alb_Serb.pdf dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2013 Për Metodat e Trajtimit për Autorët e Dhunës në Familje të Zbatuara nga Masat e Obligueshme të Trajtimit nga Alkoolizmi dhe Varësia ndaj Substancave Psikotrope, 2012
[55] Supra Note 32, neni 53.
[56] Neni 2 i KEDNJ përkufizon të drejtën e jetës si një të drejtë themelore të çdonjërit që duhet të mbrohet me ligj.

Makfire Kastrati vs. Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës."[57] Si rezultat i këtij vendimi Këshilli Gjyqësor i Kosovës adoptoi një vendim për të inkurajuar gjykatat e Kosovës për të nxjerrë në kohë urdhrat mbrojtës për viktimat e dhunës në familje.

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës vazhdon të ketë disa mangësi të mëdha në lidhje me aftësinë e saj për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive dhe me kohë akteve të dhunës në familje. Së pari, mungesa e një përkufizimi gjithëpërfshirës në Kodin Penal të Kosovës lidhur me atë që përbën një akt të dhunës në familje mbetet një faktor i rëndësishëm në reagimin ndaj rasteve të dhunës në familje. Së dyti, legjislacioni ekzistues vazhdon të jetë neutral ndaj gjinisë duke mos pranuar natyrën gjinore të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës kundër grave. Kjo ka kontribuar në legjislacionin joadekuat që nuk synon në veçanti nevojat specifike të grave dhe vajzave. Së fundmi, një sfidë e vazhdueshme është përdorimi pothuajse i joekzistent i të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut nga gjyqësori i Kosovës.

c) Mbrojtja e Viktimave të Dhunës në Familje

Viktimat e dhunës në familje në Kosovë kanë në dispozicion disa mekanizma mbrojtës. Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje përcakton tre lloje urdhrash mbrojtës, dhe atë duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes, urdhrat e mbrojtjes emergjente të lëshuara nga gjykatat dhe urdhrat e mbrojtjes së përkohshme të emergjente të lëshuar nga Policia e Kosovës jashtë orarit të rregullt të punës.[58] Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje (PSV) specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë ligjore të secilit institucion për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje siç janë Policia e Kosovës, Prokuroria, Avokatët e Viktimave, Qendrat për Punë Sociale dhe Strehimoret. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se këto institucione shpesh dështojnë në zbatimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe të PSV-ve.

Në të kaluarën, dështimet për të lëshuar urdhra për mbrojtje nga gjykatat kanë çuar në vdekje tragjike. Veçanërisht, rasti i Diana Kastratit përmendet shpesh si një dështim i hapur i gjykatës për të lëshuar urdhrat e mbrojtjes në kohën e duhur. Kastrati u qëllua për vdekje nga ish bashkëshorti i saj në qendër të qytetit të Prishtinës në maj të vitit 2011. Tre javë përpara incidentit tragjik, znj. Kastrati kërkoi dhe nuk arriti të marrë urdhër mbrojtës nga Gjykata Komunale në Prishtinë.[59] Dështimi i gjykatës për të zbatuar Nenin 16 të Ligjit për Mbrojtjen nga

[57]Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi në Rastin Nr. KI 41/12, "Gëzim dhe MakfireKastrati kundër Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2013, at: gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_41_12_ang.pdf
[58]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-182 mbi Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, 2010, në: www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf
[59] Supra Note 56.

Dhuna në Familje dhe për të lëshuar urdhrin për mbrojtje emergjente brenda 24 orëve, siç kërkohet me ligj, çoi në vdekjen e saj tragjike. Diana u qëllua në publik nga ish burri i saj, pa një urdhër mbrojtjeje të lëshuar nga gjykata në kohën kur ajo u qëllua për vdekje. Në përgjigje ndaj këtij keqpërdorimi, u dorëzua pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës një çështje gjyqësore kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përfundimisht Gjykata Kushtetuese e shpalli shtetin përgjegjës dhe shkelës të së drejtës së viktimës për jetën për shkak të pamundësisë së gjykatës për të lëshuar urdhrin e mbrojtjes në kohën e duhur.[60]

Ky vendim i Gjykatës Kushtetuese gjithashtu nxiti edhe një reagim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ata përpiluan një vendim me anë të së cilit i kërkohet gjyqtarëve që të lëshojnë urdhrat e mbrojtjes në kohë.[61] Edhe pse kjo gjë çoi drejt përmirësimit të lëshimit të urdhrave të mbrojtjes nga ana e gjykatave në kohë,[62] mbesin akoma disa çështje tjera në zbatimin e dispozitave tjera të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe PSV-ve.

Një përgjigje e shpejtë dhe e duhur e policisë është një nga parakushtet e reagimit në kohë lidhur me mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Sipas PSV-ve dhe përgjegjësive të parapara me Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Policia e Kosovës duhet të mbrojë viktimat dhe të hetojë rastet e raportuara.[63] Më tej, ata gjithashtu duhet të mbrojnë viktimat përgjatë tërë procesit dhe të përgjigjen ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunës në familje (përfshirë ekzekutimin dhe çfarëdo shkelje të urdhrave të mbrojtjes).[64] Sipas PSV-ve, policia duhet "të përdorë masa proporcionale për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje, duke arrestuar kryerësin e dyshuar me qëllim parandalimin e dhunës së mëtejshme". Policia është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e intervistës fillestare të identifikimit të viktimës që gjithashtu është regjistruar në Formularin e të Bazës së të Dhënave që janë pjesë e PSV-ve.[65] Këto intervista duhet të kryhen në dhomat që ofrojnë rehati dhe siguri për viktimën, me qëllim që policia të ndërtojë një marrëdhënie besimi me viktimën dhe të jetë në gjendje të ofrojë ndihmë të menjëhershme dhe efikase.[66] Megjithatë,

---

[60]Beteja ligjore për familjen e Dianës vazhdon edhe sot e kësaj dite, pasi që ata ende nuk e kanë marrë kompensimin nga shteti i Kosovës. Në një intervistë me KIPRED-in, Avokati i Popullit deklaroi se në mungesë të kompensimit të duhur shtetëror, aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese mund të konsiderohet thjesht deklarativ. Ndërkohë që gjyqtari i cili nuk ka lëshuar UME-në për Diana Kastratinishte pezulluar përkohësisht, ai u dekretua si anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vitin 2014

[61]Vendimi Nr. 22/2012 i KGJK-së

[62] KIPRED – Intervistë me disa akterë, përfshirë prokurorinë, policinë, dhe OShC për të Drejtat e Grave

[63] Agjencia për Barazi Gjinore, "Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, 2013, at: https://abgj.rks-gov.net/Portals/0/Procedurat%20Standarte%20të%20Veprimit%20për%20Mbrojtje%20nga%20Dhuna%20në%20Familje.pdf

[64] Ibid.

[65] Ibid. faqe 28

[66] Ibid.

në bazë të një rasti të hulumtuar nga ana e KIPRED-it, kontakti i parë i policisë me viktimën del se ka qenë i papërshtatshëm.[67]

Studimi i rastit: Marrja në pyetje e viktimave të dhunës në familje. Në këtë rast të veçantë, Prokurori i Shtetit kishte kryer një vizitë në Njësinë për Hetimin e Dhunës në Familje në Stacionin e Policisë në Gjilan. Gjatë vizitës, ai vuri re se Njësia po intervistonte viktimën dhe autorin e krimit pranë njëri-tjetrit. Ndërsa viktima dhe autori ishin ulur në dhoma të ndryshme, dera mes tyre ishte pjesërisht e hapur. Kjo do të thoshte se autori mund të dëgjonte deklaratën e dhënë nga viktima dhe viktima gjithashtu mund të dëgjonte deklaratën e autorit. Si e tillë, procedura e intervistimit ishte një neglizhim i drejtpërdrejtë i procedurave zyrtare të përshkruara nga PSV. Prandaj, prokuroria në Gjilan kërkoi hetime kundër Policisë.[68] Raste tjera të ngjashme të intervistimit jo të duhur të viktimave ishin raportuar, siç janë edhe kryerja e intervistave në ambiente jo të përshtatshme siç janë shtëpitë e viktimave.[69]

Më tej, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Policia e Kosovës është agjencia përgjegjëse e zbatimit të ligjit për lëshimin e Urdhrave të Përkohshëm të Mbrojtjes Emergjente kur lind nevoja urgjente për të mbrojtur viktimat jashtë orarit të rregullt të punës. Policia duhet gjithashtu të kryejë një Vlerësim të Rrezikshmërisë për çdo rast në mënyrë që të vlerësojë nevojat e duhura të sigurisë të viktimave. Gjatë vitit 2017, vetëm një numër i kufizuar i rasteve u regjistruan për lëshimin e UPME-ve nga Policia e Kosovës.[70] Për shembull, gjatë periudhës 2015 – 2018, vetëm 6 Urdhra të Përkohshëm të Mbrojtjes Emergjente ishin lëshuar në tërë Kosovën,[71] duke treguar kështu një tendencë të ulët në njohuri dhe përdorim të UPME-ve edhe pse shumë shpesh rastet e dhunës në familje janë të raportuara gjatë natës dhe jashtë orarit të rregull të punës të gjykatave në Kosovë. Për më tepër, procedurat e tanishme të policisë në përputhje me PSV ekzistuese nuk ofrojnë vlerësime të rregullta, të përditësuara dhe të vlefshme të rrezikut të rasteve të dhunës në familje, të cilat mund të çojnë në incidente tragjike siç është rasti i paraqitur më poshtë.

[67] KIPRED Intervistë me një prokuror të lartë në Gjilan dhe Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë.
[68]KIPRED Intervistë me një prokuror të lartë në Gjilan.
[69] KIPRED Intervistë me Avokatin e Popullit të Republikës së Kosovës, Gush 2018
[70]Prizren Intervistë me Prokurorë, Gusht 2018
[71]Të dhënat e dorëzuara nga Policia e Kosovës në KPRED, Nëntor 2018.

Rast Studimi: Vlerësimi i rrezikshmërisë nga Policia e Kosovës

Valbona Marku-Nrecaj dhe vajza e saj u vranë nga bashkëshorti, respektivisht i ati në gusht të vitit 2018. Valbona kishte raportuar dhunën dhe kërcënimet e bashkëshortit të saj shumë herë përpara incidentit, bile edhe disa orë para vdekjes së saj.[72] Më 12 maj 2018 Valbona e kishte raportuar dhunën e bashkëshortit të saj dhe ai ishte mbajte në paraburgim për vetëm një muaj – pas së cilës kohë ai ishte liruar – gjoja për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.[73] Prokuroria ishte në dijeni se i dyshuari kishte në posedim një armë zjarri. Kur Valbona kishte raportuar disa kërcënime që ajo ksihte marrë nga bashkëshorti i saj me telefon, përfshirë edhe një kërcënim 5 orë para se të ndodhte vrasja, policia kishte vlerësuar se kërcënimet nuk paraqisnin asnjë rrezik për viktimën.[74] Duke mos iu përgjigjur raportimeve të akteve të kërcënimeve të dhunës në familje dhe duke mos përdorur mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën me qëllim të parandalimit të dhunës së mëtejshme, policia ka shkelur nenin 24 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.[75]

Më tej, policia ka dështuar të kryej një vlerësim të vlefshëm dhe aktual të rrezikshmërisë me qëllim të ofrimit të shërbimit dhe mbrojtjes së përshtatshme ndaj Valbonës.[76] Edhe pse vlerësimi fillestar i rrezikut është kryer kur është intervistuar viktima dhe kur është plotësuar Forma e të Dhënave Bazike, PSV-të aktuale poashtu nuk kërkojnë që të bëhet ndonjë vlerësim i vlefshëm, i vazhdueshëm dhe i detajuar i rrezikut për rastet e raportuara më herët. Një listë kontrolli i policisë për vlerësimin e rrezikut përbëhet nga 5-6 kontrolle që nuk i plotësojnë kushtet e vlerësimit të vlefshmërisë së rrezikut.[77] Sikur policia ta përditësonte vlerësimin e rrezikut nga Forma e të Dhënave Bazike dhe menjëherë të përgjigjej ndaj kërcënimeve të jetës së saj duke urdhëruar lëshimin e një UPME, vdekja e Valbonës dhe vajzës së saj do të ishin shmangur.

Më tej, Policia nuk ka lëshuar menjëherë një Urdhër të Përkohshëm të Mbrojtjes Emergjente për Valbonën në pajtim me nenin 22 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.[78] Policia deklaroi se përgjegjësia e tyre kishte përfunduar për shkak të faktit se Valbona nuk kishte kërkuar ndonjë urdhër mbrojtje. Për më tepër policia ishte informuar se autori i krimit posedonte armë zjarri,[79] porse as polici dhe as prokurori nuk kishin kërkuar konfiskimin e armës së zjarrit nga autori i krimit. Një UPME mund të kërkohet nga palë të shumta, përfshirë viktimat, çdo person i autorizuar nga viktima, avokati i viktimës, dikush që ka një marrëdhënie familjare me viktimën,

[72] KIPRED Intervistë me Avokatin e Viktimave dhe Qendrën për Punë Sociale në Gjakovë, gusht 2018.
[73] KIPRED Intervistë me akterë, burime të brendshme.
[74] KIPRED kontakti me anëtarët e familjes së Valbonës, Gjakovë, gusht 2018.
[75]Supra Note 58. nenet 24.1 dhe 24.3
[76] Supra Note 63. faqe 29
[77] Ibid. faqe 83
[78] Supra Note 58
[79] KIPRED kontakt me anëtar të familjes së Valbonës, Gjakovë, gusht 2018.

përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale, ose çdo person me njohuri të drejtpërdrejtë të aktit apo akteve të dhunës në familje të ushtruara kundër viktimës.[80] Institucione të tjera ishin përfshirë në rastin e Valbonës, përfshirë edhe Qendrën për Punë Sociale dhe Avokati i Viktimave.[81] Të gjitha këto institucione ishin të vetëdijshme për dhunën sistemike të gjatë që po ushtrohej kundër Valbonës. Sipas nenit 22 të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Qendrat për Punë Sociale mund të kërkojnë lëshimin e një UPME-je në emër të viktimës, drejtpërdrejt kur fëmijët vihen në rrezik. Qendrat për Punë Sociale mund të kërkojnë lëshimin e Urdhrave për Mbrojtjen dhe Urdhrave për Mbrojtje të Jashtëzakonshme në rastet kur dhuna gjithashtu prek direkt fëmijët.[82]

Reagimi i dobët, mungesa e koordinimit si dhe zbatimi i dobët i roleve dhe përgjegjësive të parapara në Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë nga Policia e Kosovës, Qendra për Punë Sociale dhe palët e tjera të përfshira, përfshirë edhe shërbimet e prokurorisë kanë kontribuar në masë të madhe në rëndimin e kushteve për vdekjen e Valbonës dhe vajzës së saj nëntëvjeçare.

Shembulli i rastit më lart tregon reagimin joadekuat të policisë dhe akterëve të tjerë ndaj rasteve të dhunës në familje. Megjithëse ka pasur një përmirësim në lëshimin në kohë të urdhrave të mbrojtjes, zbatimi joadekuat i PSV-ve, si dhe përkufizimi i dobët i vlerësimit të rrezikut në kuadër të PSV-ve ekzistuese, tregojnë nevojën për përmirësime të mëtejshme. Së fundmi, intervistat fillestare të identifikimit të kryera nga policia nuk janë gjithmonë në përputhje me standardet e përcaktuara nga PSV-të dhe Konventa e Stambollit. Policia dështon të kryejë vlerësime të rregullta dhe të vlefshme për rreziqet gjatë dhe pas lëshimit të Urdhrave të Mbrojtjes. Kjo do të duhej të adresohej me ndryshimin e PSV-ve.

d) Ndjekja dhe shpallja e dënimeve në rastet e dhunës në familje

Përfundimi i mosndëshkimit për kryerësit e akteve të dhunës në familje në nivel ndërkombëtar është i njohur si një mekanizëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje për të dalë dhe raportuar krimet e dhunës në familje. Në mënyrë që viktimat të fitojnë besimin e sistemit gjyqësor dhe të kërkojnë ndihmë, sistemi gjyqësor duhet të hetojë dhe ndjekë penalisht aktet e dhunës në familje në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive. Konventa e Stambollit në veçanti kërkon që shtetet të krijojnë nga organet e zbatimit të ligjit që të hetojnë dhe ndjekin penalisht në mënyrë efektive dhe në kohë rastet e tilla. Kjo përfshin krijimin e fakteve relevante, intervistimin

[80] Supra Note 58. neni 12 dhe 13.
[81] KIPRED intervistë me avokatin e viktimës dhe qendrën për punë sociale në Gjakovë, gusht 2018
[82] Supra Note 63. faqe 43

e dëshmitarëve të ndryshëm në dispozicion dhe përdorimin e metodave më të fundit të hetimeve penale në mënyrë që rastet e dhunës në familje të kalojnë nëpër një analizë gjithëpërfshirëse.

Gjatë vitit 2017, ka pasur gjithsej 1,277 raste të raportuara të dhunës në familje pranë Policisë së Kosovës. Në nivel global konsiderohet se një në çdo tre gra përjeton dhunë fizike dhe/ose seksuale nga partneri i saj dhe një në çdo dhjetë gra kanë përjetuar marrëdhënie të dhunshme ose akte të tjera abuzimi në një moment gjatë jetës së tyre.[83] Fatkeqësisht, rastet e raportuara të dhunës në familje në Kosovë mbeten të ulëta krahasuar me incidentet aktuale të akteve të dhunshme të raportuara kundër grave. Siç është thënë, në vitin 2015, 68% e grave të intervistuara kishin raportuar se kishin përjetuar një formë të abuzimit në familje të ushtruar kundër tyre në shtëpitë e tyre.[84]

Duke qenë se nuk ka një bazë të dhënash unike për mbledhjen dhe ndjekjen e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve gjyqësore për rastet e dhunës në familje në Kosovë, është e vështirë të matet numri i saktë i rasteve të proceduara brenda të njëjtit vit. Sipas të dhënave të Policisë në 15 vitet e fundit të raportimit të dhunës në familje, çdo vit raportohen afërsisht 1,000 deri në 1,200 raste.

Kërkesat për paraburgim në rastet e dhunës në familje janë tepër të ulëta. Prej 2,959 kallëzimeve penale në vitin 2016, prokuroria ka bërë vetëm 84 kërkesa për paraburgim (2,8%). Në 2017, paraburgimi u kërkua vetëm në 115 raste (11.3%) dhe në gjysmën e parë të vitit 2018, paraburgimi u kërkua vetëm në 69 raste (5.5%).

Efektet e lirimit të autorëve të krimit, gjë që shpesh përcillet me presion kundër viktimës në shtëpitë e familjeve të tyre, kanë shpjerë viktimat shpesh drejt tërheqjes së deklaratave të tyre dhe ndjekjes penale të akteve të dhunës në familje.[85] Për më tepër, mbështetja e përgjithshme e prokurorëve mbi deklaratat e viktimave, si dhe tërheqja e mëvonshme e viktimës nga prokuroria, kontribuon në numrin e madh të rasteve të hedhura poshtë çdo vit në gjykatë. Numri i kallëzimeve penale që kanë të bëjnë me rastet e dhunës në familje të cilat janë hedhur poshtë ose janë refuzuar me aktgjykime refuzimi vazhdojnë të jenë alarmante. Në vitin 2017, mbi gjysma e të gjitha kallëzimeve penale lidhur me rastet e dhunës në familje ishin hedhur poshtë (51.6%). Në

[83]Organizata Botërore e Shëndetësisë, Vlerësimet Globale dhe Rajonale të Dhunës ndaj Grave: Mbizotërimii dhunës intime nga partnerit dhe dhunës seksuale nga jo partneri si dhe efektet shëndetësore të tij, 2013, në : www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/9789241564625/en/
[84]Supra Note 8
[85] KIPRED intervistat me akterë të ndryshëm, gusht-shtator 2018.

anën tjetër, aktgjykimet refuzuese mund të vijnë si rezultat i tërheqjes së aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit.[86] Gjatë vitit 2016 ka pasur 94 aktgjykime refuzuese, 62 në vitin 2017 dhe 20 në gjysmën e parë të vitit 2018. (Shih Tabelën 2).

Tabela 2. Shkeljet Penale lidhur me dhunën në familje			
Vitet	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale	2959	1009	1241
Kërkesat për paraburgim	84	115	69
Hedhja poshtë e kallëzimeve penale	838	521	188
Aktakuza të drejtëpërdejta	1716	1220	419
Hetimet e iniciuara	683	231	157
Aktakuzat e ngritura pas hetimeve	591	378	189
Hedhjet poshtë të procedurave pas skadimit të periudhës së parashkrimit	2	0	2
Propozimi për caktimin e masave mbrojtëse	23	24	13
Aktgjykime refuzuese	94	62	20

Dy shkaqet kryesore të raportuara në lidhje me numrin e madh të lëndëve të hedhura poshtë dhe aktgjykimeve refuzuese përfshijnë: 1) pamundësinë e prokurorëve për të krijuar një rast të fortë dhe për të mbledhur prova të mjaftueshme dhe 2) normat që kanë të bëjnë me përfundimin e sa më shumë rasteve brenda një muaji, gjë që çon prokurorët në përfundimin e shpejtë të rasteve të dhunës në familje dhe nuk i jep përparësi atyre për hetime të mëtejshme dhe të thella dhe për të bërë grumbullimin e provave.

Çështja e parë e raportuar mbi pamundësinë për të krijuar raste të forta dhe për të mbledhur dëshmi të mjaftueshme është një problem i përhapur në të gjithë Prokuroritë Themelore në Kosovë. Prokurorët kanë një tendencë për të ndërtuar rastin rreth dëshmisë së viktimës dhe të mbështeten pak më tepër në deklaratat e viktimave.[87] Kur merret parasysh numri i ulët i

[86]Arsyet tjera përfshijnë që i akuzuari më parë është dënuar ose liruar nga i njëjti akt me anë të një aktgjykimi të formës së prerë ose procedurat kundër tij janë pezulluar me anë të aktvendimit të formës së prerë; ose 1.3. afati i parashkrimit ka skaduar, nëse amnistia ose falja mbulon aktin, ose nëse ka rrethana të tjera që pengojnë ndjekjen penale (shih Kodin e Procedurës Penale Neni 363).

[87] KIPRED intervista me prokurorë, gusht dhe shtator 2018

paraburgimeve të urdhëruara kundër autorëve të krimit, lirimi i tyre i shpejtë si dhe natyra e krimeve të dhunës në familje dhe cikli i keqpërdorimit, është e qartë se mbështetja e tepërt në deklaratën e viktimës nuk është një metodë e hetimit efektiv. Cikli i abuzimit të natyrshëm në krimet e dhunës në familje çon shpesh në pajtimin mes viktimës dhe përdhunuesit si rezultat i premtimeve të dhëna nga autorët e veprës se ata do të ndryshojnë dhe nuk do të përsërisin më sjelljen e dhunshme dhe se janë penduar.[88] Në shumë raste, sapo viktima e tërhjeke dëshminë e vetë dhe pajtohet me autorin e veprës, prokuroria mbetet me një rast të dobët. Ofruesit e shërbimeve të Kosovës, të tilla si strehimore joqeveritare që ndihmojnë viktimat e dhunës në familje, deklaruan se kjo shpesh është një taktikë e përdorur qëllimisht nga prokurorët në mënyrë që rastet të rezultojnë pa hetime të mëtejshme dhe pa mbledhje të provave. Qëllimi i tyre i pretenduar shumë shpesh në ndjekjen penale të rasteve të dhunës në familje është të "ruajnë" familjen tradicionale, edhe në rastet kur kjo nënkupton "shpëtimin" e një familje jofunksionale dhe të prekur nga dhuna.[89]

Siç është thënë më sipër, qasja aktuale e prokurorëve nuk është në një linjë me kushtet e Konventës së Stambollit. Konventa në mënyrë specifike u kërkon shteteve të kryejnë hetime dhe ndjekje penale efektive dhe në kohë të rasteve me anë të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë duke mbledhur fakte relevante, duke intervistuar dëshmitarë të ndryshëm në dispozicion, si dhe duke përdorur metoda më të fundit të mjekësisë ligjore të ekzaminimit në mënyrë që rastet e dhunës në familje të përgatiten para gjykatës.

Duke u përqendruar në dëshminë e viktimës, prokurorët shpesh nuk arrijnë të mbledhin të gjitha provat e nevojshme. Prokurorët nuk u japin përparësi dëshmive të rëndësishme siç janë dëshmitë e anëtarëve të tjerë të familjes, veprimeve dhe deklaratave të viktimës kur ishin në kontakt me policinë, dëshmive fizike dhe mjekësore të mbledhura pas raportimit të krimit në polici ose provave të mbledhura në vendin e ngjarjes nga policia.[90] Për shembull, Rrjeti i Grave të Kosovës ka monitoruar një rast ku prokurori nuk ka intervistuar fare anëtarët e familjes së viktimës. Intervistat do të kishin ofruar dëshmi të mjaftueshme të një modeli të abuzimit të vazhdueshëm dhe afatgjatë. Dështime të tilla për të kryer hetime të plota janë arsyet kryesore për dënime të lehta të autorëve të krimit të dhunës në familje në Kosovë.[91]

---

[88]Berry, D.B, Domestic Violence Sourcebook, Lowell House, ISBN: 1-56565-212-6, 1995, at: https://www.ncjrs.gov/App/Publications/abstract.aspx?ID=167047

[89]Intervistat e KIPRED-it me zyrtarin e sigurimit të Shtëpisë së Sigurtë në Gjakovë, gusht 2108. Po ashtu kjo gjë është thënë nga prokurori vendor në një grup punues për ndryshimin e Kodit Penal të Kosovës lidhur me dhunën në familje, Prevalle-Prizren 12 Tetor, me pjesëmarrjen e KIPRED dhe anëtarëve të Rrjetit të Grave të Kosovës.

[90]Intervistë e KIPRED-it me Prokurorin, Shtator 2018

[91]Supra Note 5

Së dyti, numri i raportuar i lartë i aktgjykimeve refuzuese dhe i aktakuzave të hedhura poshtë lidhet gjithashtu me mungesën e prioritizimit të rasteve të dhunës në familje. Profesionistët, duke përfshirë prokurorët, vazhdojnë të shohin dhunën në familje si çështje private dhe në këtë mënyrë nuk janë të gatshëm t'i marrin seriozisht këto krime.[92] Në vitin 2018, Këshilli Prokurorial ka krijuar kuota që kanë nevojë të plotësohen nga prokurorët në baza mujore dhe vjetore.[93] Sipas këtyre kuotave, prokurorët e departamenteve të përgjithshme të prokurorive themelore duhet të përfundojnë të paktën 23 aktakuza në baza mujore (253 në baza vjetore), prokurorët në departamentet e krimeve të rënda duhet të përfundojnë 6 aktakuza në baza mujore (66 në baza vjetore).[94] Siç është thënë nga disa prokurorë, këto kuota kanë kontribuar në nivel të dobët të cilësisë së aktakuzave.[95]

Për më tepër, prokurorët kanë vënë në pah se mungesa e një përkufizimi të Dhunës në Familje brenda Kodit Penal pengon përpjekjet e tyre për të ndjekur penalisht këto raste.[96] Vetëm kohët e fundit, pas raportimit të rritur të mediave dhe aktivizimit nga shoqëria civile për t'u përgjigjur rasteve të dhunës në familje,[97]shërbimet prokuroriale të Kosovës kanë ndërmarrë disa hapa drejt përmirësimit të reagimit të tyre ndaj rasteve të dhunës në familje.

Në maj të vitit 2017, Këshilli Prokurorial i Kosovës emëroi prokurorë në çdo prokurori themelore për t'i dhënë prioritet lëndëve të dhunës në familje.[98] Emërimet u përmendën në bazë të kërkesave të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020. Në këtë pikë pothuajse të gjitha zyrat themelore të prokurorive në komunat e Kosovës kanë caktuar prokurorët për të caktuar prioritet dhe për të vepruar si koordinatorë në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.

Emërimet u përmendën në bazë të kërkesave të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2016-2020. Në këtë pikë pothuajse të gjitha zyrat themelore të prokurorive në komunat e Kosovës kanë caktuar prokurorët për të vepruar si koordinatorë në

[92]Intervistë e KIPRED-it me Prokurorë,gusht dhe shtator 2018
[93] Këshilli Prokurorial i Kosovës, Udhëzimi AdministrativNr. 01/2018 në caktimin e normave orientuese për prokurorët e shtetit, Prishtina, 2018
[94] Ibid.
[95] Intervistë e KIPRED-it me Prokurorë, shtator 2018
[96]Intervistë e KIPRED-it me Prokurorë, shtator 2018
[97]Një sërë protestash kanë ndodhur pas vrasjes së ValbonaNrecaj dhe vajzës 9 vjeçare nga burri/babai i tyre. Grupet e protestave u organizuan nga anëtarë të shoqërisë civile dhe aktivistë në Gjakovë, Prishtinë, Prizren etj. Gjatë muajit gusht 2018 duke kërkuar përgjegjësi institucionale për trajtimin e rasteve të rastësishme të dhunës në familje. Shih për shembull artikujt në Bota Sot dhe Koha Ditore në https://www.botasot.info/aktuale-lajme/934233/per-vrasjen-e-valbones-me-te-bijen-kerkohet-doreheqje-te-personave-pergjegjes/dhehttps://www.koha.net/arberi/110018/detaje-te-ktv-se-nga-krimi-i-paralajmeruar-ne-brekoc-te-gjakoves-i-pandaluar-nga-policia/
[98]Këshilli Prokurorial i Kosovës, Procedurat Standarde të Veprimit për Rritjen e Efikasitetit në Trajtimin e rasteve të Dhunës në Familje, Maj 2017

trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore.[99] Megjithatë pavarësisht emërimeve mbeten akoma shumë probleme. E para, ndonëse prokurorët e emëruar kanë marrë trajnime, veçanërisht nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, ata ende kanë nevojë për ngritje të kapaciteteve.[100] E dyta, shumë prej prokurorëve të emëruar merren gjithashtu edhe me raste tjera, që mund t'i pengojnë ata në përqendrimin e energjisë dhe kohës së tyre në rastet dhunës në familje.[101] E treta, jo të gjitha rastet shkojnë tek prokurorët e emëruar, duke bërë që shumë raste të dhunës në familje të shkojnë tek prokurorët e pa trajnuar.[102] Dhe e fundit, megjithëse shërbimet prokuroriale kanë caktuar prokurorët për të trajtuar dhe për t'u dhënë përparësi rasteve të dhunës në familje, gjyqësori nuk ka emëruar gjyqtarë për të trajtuar raste specifike të dhunës në familje në procedurat e tyre penale. Kjo bënë që rastet e dhunës në familje të trajtohen nga gjyqtarë të pa trajnuar dhe që nuk e kuptojnë dinamikën e rasteve të dhunës në familje.[103]

Rast studimi: Dështimi për të kategorizuar rastet e dhunës në familje në mënyrë adekuate. Në vitin 2011, tre ditë pas martesës, Antigona Morina kishte vdekur për shkak të gjakderdhjes së madhe. Edhe përkundër faktit se ajo kishte filluar të gjakos në natën e martesës së saj, burri i Antigonës kishte vazhduar të kryej marrëdhënie seksuale të dhunshme me të[104]dhe nuk kishte arritur që ta dërgojë tek ndonjë mjek profesionist. Në vend të kësaj, ajo ishte dërgua tek një sheh, i cili ofronte terapi tradicionale. Pas vdekjes së Antigonës, prokuroria ngriti padi penale kundër bashkëshortit të saj në pajtim me nenin 251 të Kodit Penal, mbi "Shkeljet e Detyrimeve Familjare."[105]Ai u shpall i pafajshëm nga Gjykata Themelore e Gjakovës (Dega në Rahovec). Megjithatë, ankesa e parashtruar nga prokuroria kishte humbur dhe asnjëherë nuk kishte arritur në Gjykatën e Apelit.[106] Pretendohet se gjyqtari në detyrë (i cili tani është i pensionuar) e kishte fshehur ankesën qëllimshëm.[107]Për shkak të presionit nga mediat, aktivistet e grave dhe OSHC-të, prokuroria ri-dërgon ankesën në fillim të vitit 2018. Rrjeti i Grave të Kosovës ka punësuar një avokat për të përfaqësuar familjen e Antigonës gjatë procesit të apelimit.[108]

---

[99]Intervistë e KIPRED me Prokurorin e Shtetit, shtator 2018.
[100] Ibid.
[101] Ibid.
[102] Supra Note 8 dhe Intervista e KIRPED me Prokurorin e Shtetit, shtator 2018
[103] Ibid.
[104]Sipas raportit të Mjekësisë Ligjore të përbashkët me Rrjetin e Grave të Kosovës, shkaku i vdekjes ishte gjakderdhja që erdhi si rezultat i seksit të dhunshëm anal..
[105]Banjska, Iliriana, for Kosovo 2.0, "Edhe sa thirrje duhet të bëhen" "How many calls does it take?", 2018, Webfaqe e qasur më 20.10.2018, at: kosovotwopointzero.com/en/how-many-calls-does-it-take/
[106]Ibid.
[107] KIPRED Intervista e KIRPED me Prokurorë, shtator 2018.
[108]Intervistë me Rrjetin e Grave të Kosovës, Korrik 2018.

Siç është ilustruar nga ky rast studimi, prokurorët shpesh nuk i kategorizojnë në paditë e tyre krimet e caktuara si dhunë në familje. Në rastin e Antigonës, krimi ishte kualifikuar nga prokuroria si "Shkelje e Detyrimeve Familjare" bazuar në nenin 251 të Kodit Penal. Sipas këtij neni, nëse dikush nuk kujdeset për një anëtar të familjes i cili është i paaftë për t'u kujdesur për veten e tij, ata duhet të dënohen me burgim prej tre muaj deri në tre vjet.109 Në fakt, vdekja e Antigonës është dashur të klasifikohet ndryshe, edhe në bazë të nenit 181 të Kodit Penal si "Vrasje e Neglizhuar"110 edhe në bazë të nenit 189 "Lëndim i rëndë trupor".111 Sipas 181 të Kodit Penal "Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia, dënohet me burgim prej gjashtë (6)muaj deri në pesë (5) vjet." Më tej, sipas nenit 189 të Kodit Penal, "2. Kushdo që shkakton lëndim trupor ose e dëmton shëndetin e personit tjetër dhe kjo rezulton me: 2.1 rrezikim të jetës së personit tjetër; 2.2 paaftësimin ose dobësimin e përhershëm të një pjese vitale të trupit të personit tjetër; 2.3 paaftësimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për çfarëdo lloj pune; 2.4. shëmtimin e përhershëm të personit tjetër; ose 2.5. dëmtimin e përhershëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet." Në rastin e Antigonës, dështimi për të kualifikuar drejtpërsëdrejti veprën penale dhe lëndimet e shkaktuara ndaj trupit të saj (i cili u pranua edhe nga Raporti Mjekësor i Mjekësisë Ligjore), çoi në trajtimin jo të duhur të çështjes nga ana e gjykatave. Sipas kushteve të përcaktuara në Konventën e Stambollit, shtetet duhet të veprojnë në përputhje me rëndësinë e akteve të kryera kundër grave.[112]

Zvogëlimi i akteve të dhunës kundër grave apo edhe kualifikimi i gabuar i akteve të dhunës në familje janë taktika që shpesh përdoren nga sistemi gjyqësor me qëllim të nxjerrjes së dënimeve minimale në rastet e dhunës në familje (përfshirë edhe dhënien e gjobave, caktimin e dënimit me kusht apo edhe periudhën provuese).[113]

Sipas të dhënave të monitoruara nga KIPRED-i, numri i rasteve të cilat marrin vetëm urdhra ndëshkues përmes gjykimit të gjykatave është i lartë. Urdhrat ndëshkues jepen kur prokurori kërkon masat e mëposhtme: *"Një gjobë, ndalimi i ngasjes së një automjeti, urdhri për të publikuar një gjykim, konfiskimin e një objekti, një vërejtje gjyqësore ose konfiskimi i përfitimit material të fituar nga komisioni*

---

[109] Supra Note 42, neni 251
[110] Supra Note 42. neni 181. Gjithashtu konfirmuar në konsultim të ngushtë me avokatin aktual të familjes së Antigona Morinës në procedurën e ankesës, znj. Fehmije Bytyqi.
[111] Ibid. neni 189.2.
[112] Fjalimi i Elda Moreno,Shefe e Këshillit të Evropës për Barazinë Gjinore dhe Dinjitetin e Njeriut, në Shkollën Ekonomike të Londrës në lidhje me Konventën e Stambollit, 2013. Në dispozicion në: http://www.lse.ac.uk/humanRights/documents/2013/20130307Moreno.pdf
[113] Supra Note 2

i një shkelje penale."[114] Prokurorët kërkojnë lëshimin e urdhrave ndëshkues nga gjykatat duke u kërkuar që të caktojnë dënime të caktuara për te akuzuarit pa mbajtur fare seancën kryesore.[115]Prandaj, urdhrat ndëshkuese shpesh bëjnë që gjykatat të shqiptojnë gjoba dhe t'i kryejnë rastet pa mbajtjen e seancave kryesore, duke mos hetuar plotësisht rastet e raportuara të dhunës në familje. Tendenca e vazhdueshme e shërbimeve prokuroriale për t'i dhënë prioritet të ulët rasteve të dhunës në familje, së bashku me ndjenjën e përbashkët të mosndëshkimit midis autorëve të krimit, do të vazhdojë të krijojë një kulturë të mosndëshkimit e cila pranon dhunën ndaj grave dhe vajzave si një normë.[116]

Urdhrat ndëshkues, kryesisht të lëshuar në formën e gjobave, shpesh lëshohen me anë të aktvendimeve në rastet e dhunës në familje. Urdhra të tillë janë lëshuar në 300 raste në vitin 2015, 397 raste në vitin 2016 dhe 44 raste në vitin 2017.[117]Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, janë lëshuar 28 raste të urdhrave ndëshkues. (Shih Tabelën 3) Sipas një zyrtari të lartë të sistemit prokurorial në Kosovë, asnjë rast i dhunës në familje nuk duhet të marrë urdhër ndëshkues me aktgjykim.[118] Sipas Konventës së Stambollit, mosndëshkimi i autorëve të krimit çon në rritjen e pranimit shoqëror të dhunës në familje.[119]Ky mosndëshkim i autorëve të krimit është ilustruar më tej me dhënat ekzistuese të gjyqësorit. Gjatë periudhës 2015-2018, vetëm 40.4% e rasteve të gjykuara kanë marrë aktvendime fajësuese.

Përveç kësaj, reagimi gjyqësor mbetet i dobët. Çdo vit, ka disa raste që nuk gjykohen për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit. Sipas të dhënave të dorëzuara në KIPRED nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, në vitin 2015, 18 raste nuk janë gjykuar për shkak të parashrkimit. Për më tepër, në vitin 2016, 28 raste nuk janë gjykuar dhe në vitin 2017, 15 nuk janë gjykuar (Shih tabelën 3). Reagimi i ngadaltë e gjyqësorit përkeqëson më tej mosndëshkimin ekzistues të autorëve të krimit.

Për më tepër, Konventa e Stambollit kërkon nga shtetet që të krijojnë programe parandaluese dhe trajtuese për autorët e krimit.[120] Në përputhje me Konventën, Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje parasheh trajtim dhe trajtim psiko-social[121]nga varësia nga substancat psikotrope dhe alkooli.[122] Këto programe rregullohen më tej nga dy Udhëzime Administrative, njëri mbi trajtimin

---

[114] Ibid.
[115]Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës , Neni 493
[116] Supra Note 50
[117]Të dhënat e nxjerra nga Këshilli Prokurorial i Kosovës
[118]Intervistë e KIPRED-it me Prokurorin, shtator 2018.
[119] Supra Note 2
[120] Supra Note 2. neni 16
[121] Supra Note 58. neni 4
[122] Ibid. neni 9

psikosocial,[123]dhe tjetri në lidhje me trajtimin e alkoolizmit dhe substancave të tjera.[124]Këto dy udhëzime janë kritikuar për shkak se sugjerojnë në mënyrë indirekte se sjellja psiko-sociale dhe varësia janë shkaqet rrënjësore të dhunës në familje.[125] Megjithatë, gjetjet e KIPRED kanë treguar se këto udhëzime janë të rralla dhe thuajse fare të pa zbatuara.[126] Vetëm 17 masa për trajtim të detyrueshëm ishin urdhëruar në vitin 2016, 11 në vitin 2017 dhe 8 në gjysmën e parë të vitit 2018. (Shih tabelën 3).

Tabela 3. Rastet Penale në lidhje me dhunën në familje të dënuara nga gjykatat

Vitet	2015	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i kallëzimeve penale për periudhën raportuese	2667	2959	1009	1241
Urdhrat ndëshkues të lëshuar me aktgjykim.	300	394	44	28
Raste të mbyllura për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit	18	28	15	0
Me aktgjykim lirues	11	12	2	0
Aktgjykim fajësues	901	1055	776	455
Masat për trajtim të detyrueshëm	23	17	11	8

Sistemi gjyqësor kohët e fundit ka regjistruar një rast në të cilin është trajtuar një vepër e dhunës në familje në mënyrë të përshtatshme dhe të menjëhershme. Në korrik të vitit 2018, një autor i krimit të dhunës në familje u dënua me 3 vjet burg nga Gjykata Themelore e Prishtinës. Rasti kishte radhitur një numër rrethanash të lehta dhe rënduese gjatë arsyetimit të dënimit.

Rrethanat rënduese të shqyrtuara në aktgjykim ishin shembullore dhe të përshtatshme për rastin e një abuzimi sistematik në familje. Rrethanat rënduese në aktgjykim përfshinin: mungesën e keqardhjes nga ana e autorit të krimit, siç ilustrohet nga e qeshura e tij gjatë dhënies së dëshmisë nga ana e viktimës; dhuna afatgjate fizike dhe psikologjike; gjendja emocionale e viktimës, e cila

[123]Qeveria e Republikës së Kosovës, Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psikosocial të autorëve të krimit të dhunës në familje,2012, në: gbvaor.net/wp-content/uploads/2013/02/AI-imple-Law-aginst-DV-psychosocial-treatment-of-perpetrator-Eng-Alb_Serb.pdf
[124]Ministria e Shëndetësisë, Udhëzimi Administrativ nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të autrëve të krimit të dhunës në familje ndaj të cilave është shqiptuar masa për trajtim mjekësor të detyrueshëm nga alkoolizmi dhe varësia ndaj substancave psikotrope,2013, në: https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/Udhezim%20Administrativ%2002-2013.pdf
[125]Supra Note 8
[126] Intervistë në Qendrën për Punë Sociale në Gjakova tregon se prej hyrjes në fuqi të këtyre udhëzimeve, asnjë autor krimi nuk është dërguar tek ata për trajtim .

vazhdimisht ishte e pasigurt për veten dhe deklaratat e saj; fakti që dhuna ishte përdorur në prezencën e djalit të tyre 4 vjeçar.

Megjithatë, Gjykata e Apelit uli dënimin nga tre vjet në tetëmbëdhjetë muaj. Ky vendim ishte pjesërisht i bazuar në ankesën e vetë viktimës, i cili tha se dënimi fillestar ishte kundër qëllimeve të saj të vërteta dhe kontekstit të rastit. Ajo shtoi se nuk e konsideronte veten si një palë e dëmtuar në procedimet penale, megjithatë ajo kërkoi masa mbrojtëse në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe donte të paralajmërojë autorin e krimit kundër abuzimit familjar që ajo kishte vuajtur përgjatë viteve. Ajo theksoi se nëse autori i krimit do të mbahej në burg për 3 vjet kjo do të shkatërronte familjen dhe se ajo dhe djali i saj po prisnin kthimin e burrit dhe babait të tyre, pasi burri është shtylla kryesore e familjes.

Megjithatë, Gjykata e Apelit nuk arriti të kuptojë se viktima mund të ketë paraqitur ankesën për shkak të presionit që ajo mund të ketë marrë nga rrethanat e saj shoqërore si dhe varësinë e saj ekonomike dhe emocionale si viktimë e dhunës në familje. Për më tepër, Prokurori i Shtetit nuk ka marrë pjesë aspak në procedurën e ankesave dhe viktima nuk ishte e përfaqësuar gjatë procedurës së apelit nga një përfaqësues ligjor.

Ky rast ilustron reagimin joadekuat të prokurorisë dhe gjykatave për të kuptuar ciklin abuziv të dhunës dhe presionin social të vendosur ndaj viktimës, që shpesh çon në tërheqje dhe ankesë. Ndëshkimi i zvogëluar nga gjykata e apelit gjithashtu nuk ka marrë parasysh kërkesat e Udhëzuesit për Politikën Ndëshkimore, të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, duke kërkuar që faktorët e dhunës së vazhdueshme, dhuna e kryer para anëtarëve të familjes, efektet psikologjike ndaj viktimës dhe familjes duhet të konsiderohen si rrethana rënduese.[127]

Në të shumtën e rasteve, të dhënat ekzistuese kanë vazhduar të demonstrojnë shkallën e lartë të rasteve të hedhura poshtë nga shërbimet prokuroriale. Në vitin 2017, mbi gjysma e të gjitha rasteve u hodhën poshtë. Shumë raste kanë marrë gjykime refuzuese. Dy faktorë kontribues janë paaftësia e prokurorëve për të kuptuar dinamikën e dhunës në familje, mbështetja e tepërt e prokurorit mbi deklaratën e viktimës. Rastet e analizuara kanë treguar gjithashtu se dënimi minimal i autorëve vazhdon të përforcojë një kulturë të mosndëshkimit midis autorëve të dhunës në familje.

[127] Shih Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës, 2018. Në www.gjyqesori-rks.org/GetDocument/8426

e) Ndërmjetësimi dhe pajtimi në rastet e dhunës në familje

Konventa e Stambollit ndalon zgjidhjen alternative të kontesteve, duke përfshirë pajtimin dhe ndërmjetësimin në rastet e dhunës në familje.[128] Në veçanti, Konventa ndalon proceset e detyrueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të ndryshme si ndërmjetësimi ose pajtimi sepse ajo njeh pamundësinë e viktimës për të marrë pjesë në një proces të tillë në nivel të barabartë. Për shkak të dinamikës së dhunës në familje dhe fuqisë së marrëdhënieve të tilla, viktimat nuk do të jenë në pozitë të barabartë me autorët e veprës në proceset e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.[129]

Përpjekjet e pajtimit mbeten të përhapura në të gjitha institucionet dhe në një masë të madhe nga ofruesit e shërbimeve, duke përfshirë strehimoret për ofrimin e ndihmës dhe mbrojtjes ndaj viktimave të dhunës në familje. Siç tha një e intervistuar, "*Pajtimi përdoret për të larguar problemin nga vetja*".[130] Një e intervistuar tjetër tha "*struktura gjyqësore institucionale vepron tërësisht në drejtim të pajtimit mes viktimës dhe autorit të krimit*".[131]Përpjekjet e pajtimit janë evidente edhe në nivelin e gjykatës. Për shembull në një rast një gjyqtar vazhdimisht e kishte shtyrë seancën me arsyetimin se gjykata po ofronte kohë shtesë për të pajtuar çiftin.[132]Shtyrja vazhdoi derisa burri u largua nga vendi bashkë me fëmijët.[133]Përpjekje tjera të pajtimit vazhdojnë të raportohen edhe brenda policisë. Janë raportuar raste ku policia i ka thënë viktimës se duhet të përpiqen të "ruajnë" familjen dhe ta vënë familjen në rend të parë.[134]

Më tej sipas Ligjit të Kosovës për Ndërmjetësim i adoptuar në gusht të vitit 2018, në mënyrë eksplicite ndalohet ndërmjetësimi në rastet e dhunës në familje.[135] Deri në qershor të vitit 2016, shumë prokurorë përdorën masa alternative për të pajtuar rastet e dhunës në familje. Prandaj, vetëm në qershor të vitit 2016, Prokuroria e Shtetit lëshoi një shënim udhëzues që ndalonte përdorimin e masave alternative si pajtimi në rastet e dhunës në familje.[136] Sipas këtij udhëzimi, Zyra e Prokurorit thekson se ata kanë vërejtur se në rastet e shkeljes së urdhrave të mbrojtjes që duhet ndjekur sipas detyrës zyrtare dhe gjithashtu në rastet e dhunës në familje, prokurorët shpesh e dërgojnë rastin në një organ pajtimi të certifikuar. Për më tepër, udhëzimi përmban një

---

[128] Supra Note 2, Konventa e Stambollit, Neni 48
[129]Supra Note 50.
[130]Intervistë e KIPRED me ofrues të shërbimit, gusht 2018
[131]Intervistë e KIPRED me ofrues të shërbimit,shtator 2018.
[132]Supra Note 8.
[133] Ibid.
[134]Intervistë e KIPRED me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore dhe Institucionin e Avokatit të Popullit, shtator 2018.
[135]Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-009 mbi Ndërmjetësimin, 2018, në: https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/078A2A69-F572-4826-AC20-61937AADD2FA.pdf
[136]Zyra e Kryeprokurorit t ë Shtetit, Udhëzues 360/16 qershor 2016.

shpjegim se pse pajtimi nuk duhet të përdoret, duke përdorur arsyetimin e modeleve ciklike të autorëve të dhunës në familje.[137]Megjithatë, ndërkohë që udhëzuesi ndalon përdorimin e pajtimit si masë alternative, ajo nuk ka ndaluar prokurorët individualë që të ndërmjetësojnë ndërmjet palëve. Në të vërtetë, një nga kryeprokurorët e Prokurorive Themelore në Kosovë deklaroi se Udhëzuesi kishte ndërprerë ndërmjetësimin zyrtar, por prokurorët individual vazhdojnë të ndërmjetësojnë midis palëve.[138]

Të intervistuarit kanë theksuar gjithnjë se Qendrat për Punë Sociale shpesh angazhohen në përpjekjet e tyre për të pajtuar palët. Në një rast të raportuar në vitin 2018, strehimorja në komunën e Gjakovës ishte duke strehuar një grua që kishte shpëtuar nga një mjedis i dhunshëm në të cilin u abuzua në mënyrë të përsëritur nga bashkëshorti i saj. Gjatë një takimi ku mori pjesë një përfaqësues i strehimores, punonjësi i Qendrës për Punë Sociale,me viktimën dhe abuzuesin, abuzuesi vazhdoi të kërcënonte viktimën në prani të zyrtarëve. Abuzuesi në mënyrë të përsëritur i tha viktimës se "...*Prap do të të rrehi nëse i përsëritë ato sjellje".*Edhe në atë situatë, punonjësi social vazhdimisht insistoi që viktima dhe abuzuesi duhet të pajtohen dhe të i "*shtrëngojnë duart*" si shenjë pajtimi. Përpjekjet e pajtimit vazhdojnë të bëhen pa një kuptim të natyrës së vërtetë të abuzimit në familje dhe pa marrë në konsideratë dinamikën e rasteve të tilla. Siç u tha nga një përfaqësues i nivelit të lartë të ekipit hulumtues, ai "*e kupton pse ndodhin përpjekjet e pajtimit*" dhe se ato janë "*të bazuara në qëllime të mira.*"[139]

Duke marrë parasysh dinamikën e dhunës në familje, institucionet duhet tërësisht të përmbahen nga përpjekjet e pajtimit. Dhuna në familje është një model ciklik i karakterizuar nga një kombinim i periudhave më të qeta dhe sjelljeve abuzive. Në mënyrë të veçantë, ka tre faza të dallueshme në ciklin e abuzimit.[140] Faza e parë është pozitive dhe karakterizohet nga marrëdhënie të ngushta dhe një qëndrim simpatik dhe i butë nga ana e abuzuesit. Kjo çon në fazën e dytë, ku zhvillohen tensione përmes xhelozisë dhe paranojës dhe përfundojnë me dhunë.[141] Pas dhunës, zhvillohet një fazë e muajit të mjaltit ku abuzuesi kthehet dhe bëhet sërish sharmant dhe tregon kujdes ndaj viktimës.[142] Nëse punëtorët social, policia, shërbimet prokuroriale dhe institucionet e tjera promovojnë dhe përfshihen në përpjekje të pajtimit, ata e shtyjnë viktimën drejt e në ciklin e abuzimit dhe e vënë në rrezik jetën e viktimës në mënyrë potenciale.

---

137 Ibid.
138 KIPRED Interview with Prosecutor, September 2018.
139 Interview with National Coordinator, August 2018.
140Fisher and Lab, "Encyclopaedia of Victimology and Crime Prevention, Volume 1, 2010, page 257.
141 Ibid.
142 Ibid.

f) Strehimoret për Viktima të Dhunës në Familje

Nëntë strehimore të dhunës në familje sigurojnë një vend të përkohshëm dhe të sigurt për viktimat e dhunës në familje në Kosovë.[143] Në krahasim me standardet e përcaktuara nga Konventa e Stambollit, numri i strehimoreve vazhdon të jetë i ulët në mbarë Kosovën. Sipas Konventës së Stambollit, strehimoret duhet të ofrohen në numër të mjaftueshëm dhe duhet të jenë lehtësisht të arritshme nga viktimat.[144] Më tej, Raporti Shpjegues i Konventës së Stambollit rekomandon që një strehimore duhet të jetë e disponueshme për 10,000 banorë.[145] Gjithashtu, Konventa thotë se strehimoret duhet të marrin në konsideratë efektet e dhunës në familje dhe procesin e rimëkëmbjes në mënyrë që të shmanget ri-viktimizimi.[146]

Strehimoret në Kosovë janë të licencuara dhe ofrojnë shërbimet e tyre me mbështetje financiare të pjesshme të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Strehimoret ofrojnë strehim të përkohshëm dhe mbrojtje për viktimat, si dhe ndihmë në proceset e riintegrimit dhe rehabilitimit.[147] Viktimat mund të drejtohen në strehimore nga institucione të ndryshme, duke përfshirë policinë, por dhe drejtpërdrejt nga viktimat.[148] Strehimoret mund t'i strehojnë gratë deri në 6 muaj, por është raportuar se kanë strehuar gratë për periudha më të gjata.[149] Ato aktualisht marrin financime nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Thirrja është botuar sipas kritereve të përcaktuara në Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve.[150]

Strehimoret ekzistuese gjithashtu përballen me sfida të shumta, sidomos mungesa e financimit të qëndrueshëm.[151] Në të kaluarën, financimi ishte i barabartë me 50% të kostove të përgjithshme të strehimoreve për të ndihmuar dhe mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Sot, ky financim qëndron në rreth 30%.[152] Shumica e strehimoreve vazhdojnë të jenë të varura nga donatorët ose përkrahen herë pas here nga komunat. Për më tepër, disa prej strehimoreve vazhdojnë të

---

[143] Supra Note 35. Faqe 28
[144]Supra Note 2.
[145]Supra Note 50. Faqe 135
[146]Ibid. Faqe 22
[147] Ibid.
[148] Supra Note 8, Faqe 76
[149] KIPRED Intervista me përfaqësues të strehimoreve, Gusht 2018
[150]Ministria e Financave, Rregullorja Mf - Nr - 04/2017 për Kritere, Standarde dhe procedura në financimin public të OJQ-ve, 2017, at: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=14831
[151]Intervistat e shumta të KIPRED me aktivistët e të drejtave të grave dhe përfaqësuesit e strehimit në Kosovë, Korrik dhe Gusht 2018.
[152]KIPRED Intervista me përfaqësues të strehimoreve, Gusht 2018

paguajnë çmime të larta për faturat e energjisë elektrike dhe të ujit, pasi ato konsiderohen si biznese nga kompanitë e energjisë elektrike dhe ujit.[153]

Megjithëse disa strehimore nuk paguajnë qira, sepse komunat u kanë siguruar toka ose donatorët kanë ndërtuar shtëpitë e tyre (siç është rasti për strehimoret e Gjakovës, Gjilanit dhe Prishtinës), strukturat ekzistuese shtetërore komunale, duke përfshirë edhe në nivel lokal shpesh pengojnë funksionimin e punës së strehimoreve.

Për shembull, Shtëpia e Sigurt në Gjakovë ka raportuar të ketë filluar prodhimin e produkteve të brumit dhe ëmbëlsirave në qendër të qyetit për të krijuar aktivitet ekonomike për gratë e strehuara, si dhe për të siguruar mjete të vetëqëndrueshme për strehimin. Strehimorja angazhohen viktimat gra të dhunës në familje në prodhimin e produkteve të brumit dhe ëmbëlsirave dhe në shitjen e produkteve në vende të ndryshme duke përfshirë shkollat aty pranë. Fitimet përdoren për të siguruar që ka fonde të mjaftueshme për të vazhduar strehimin e grave dhe për të siguruar më tej pavarësinë ekonomike të viktimave të strehuara sipas nevojave. Sidoqoftë, ky hap inovativ ka hasur në reagim të ashpër. Së fundi këtë vit, strehimorja u vizitua nga Policia e Kosovës dhe Inspektorati Komunal të cilët kërkuan që të ndalonin prodhimin, sepse është e ndaluar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që OJQ-të të angazhohen në tregti. Ky ndalim nuk u interpretua në mënyrë të ligjshme, pasi nuk ishte në përputhje me Ligjin Nr. 03 / L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare.[154] Sipas nenit 16 të këtij ligji, "OJQ-të mund të angazhohen në aktivitete ekonomike, për sa kohë të ardhurat përdoren për të përmbushur qëllimet e OJQ-së."[155] Kjo masë kishte efektin e ndërprerjes së prodhimit të ëmbëlsirave për strehimoren dhe si rezultat ndërprerjen e programit ekonomik të mbështetjes për viktimat. Është pjesë e detyrave te strehimoreve të punojnë për të krijuar tek viktimat një ndjenjë kontrolli mbi jetën e tyre, e cila në shumë raste përfshin punën për sigurinë financiare (në veçanti pavarësinë ekonomike nga sulmuesi).

Shkurtimisht, pavarësisht presionit të vazhdueshëm nga qytetarët dhe OSHC-të, dhuna në familje vazhdon të mos shihet si një prioritet i lartë në agjendën politike në Kosovë.[156] Për shembull, Strategjia ekzistuese e Sigurisë e Republikës së Kosovës, e miratuar në vitin 2011,[157] nuk i referohet dhunës në familje si një çështje apo kërcënim për sigurinë edhe pse ka pasur një rritje të

---

[153] Ibid.

[154]Kuvendi i Republikës së KosovësLigji No 03/L-134 mbi Lirinë e Asocimit në organizatat joqeveritare, 2009, at: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2629

[155] Ibid. Neni 16.2

[156]Konkluzionet e Panelit, "Konferenca: Drejtësia për gratë e vrara si rezultat i dhunës në familje në Kosovë, maj 2018

[157]Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia e Sigurisë e Republikë së Kosovë 2011, në: www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_E_SIGURISE_E_REPUBLIKES_SE_KOSOVES.pdf

kohëve të fundit në Kosovë për numrin e raportuar të incidenteve dhe vrasjeve për shkak të dhunës në familje. Përveç kësaj, të dhënat e policisë kanë treguar se në dhjetëvjeçarin e fundit, raportimi i dhunës në familje mbetet ndër më të lartat nga krimet e raportuara në Kosovë, me një mesatare prej 1,000 rastesh të raportuara në baza vjetore. Megjithatë, këto statistika nuk diskutohen as nuk merren parasysh gjatë hartimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës.[158] Që nga viti 2015, institucionet e Kosovës nuk janë udhëzuar nga një plan veprimi ose strategji specifike për gratë, paqen dhe sigurinë.[159] Strategjia aktuale që bën thirrje për t'i dhënë fund dhe përgjigje të menjëhershme për rastet e dhunës në familje parasheh që deri në vitin 2020 të gjitha institucionet e Kosovës duhet të jenë përgjegjës dhe të rreptë në zbatimin e ligjeve, duke bërë thirrje për "zero tolerancë" kundër dhunës në familje.

Për shkak të urgjencës së rasteve dhe incidenteve të raportuara çdo vit për dhunën në familje, është e domosdoshme që dhuna në familje të trajtohet me urgjencë dhe të trajtohet si një kërcënim sigurie për shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve të saj. Për më tepër, institucionet përgjegjëse, duke përfshirë Koordinatorin Kombëtar kundër Dhunës në Familje, duhet të kërkojnë zbatimin e menjëhershëm të politikës së "Tolerancës Zero" nga të gjitha institucionet përgjegjëse në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Kosovës kundër dhunës në familje.

Për më tepër, duke pranuar pavarësinë e gjykatave, Konventa e Stambollit i këshillon shtetet të sigurojnë mesazhe të qarta për t'i dhënë fund dhunës brenda familjes, duke lëshuar udhëzime të përshtatshme për gjykatat në zbatimin e dënimeve të përshtatshme kundër dhunuesve të dhunës në familje. Konventa në veçanti kërkon që shtetet të ndërmarrin masa që i konsiderojnë rrethanat rënduese në përcaktimin e duhur të dënimeve me veprat penale të kryera. Sidomos në rastet e dhunës së përsëritur, abuzimit sistematik të anëtarëve të familjes, dhunës kundër personave të pambrojtur (përfshirë fëmijët) dhe përdorimin e armëve, dëmi i rëndë fizik dhe psikologjik i viktimës janë rrethana që gjykatat duhet të marrin parasysh. Ndër këto rrethana rënduese janë edhe sjelljet recidiviste të dhunuesit.[160]

Si përfundim, pamundësia e shtetit për t'i dhënë përparësi akteve të dhunës në familje ka çuar në një kulturë institucionale që injoron rastet e dhunës në familje dhe zhvillon ndjenjën e

---

[158]KIPRED, Sektori i Sigurisë në Kosovë nga Perspektiva Gjinore, 2016, në:www.kipred.org/repository/docs/SECURITY_SECTOR_IN_KOSOVO_FROM_GENDER_PERSPECTIVE_432844.pdf

[159]Plani i Veprimit i Kosovës për Zbatimin e Rezolutës 1325 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë përfundoi në vitin 2015. Agjencia e Kosovës për Barazi Gjinore po harton aktualisht Programin e ri të Kosovës dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore me qëllim të mbulimit të çështjeve që lidhen me gratë, dhe siguria.

[160]Supra Note 50. Neni 46

mosndëshkimit për autorët e dhunës në familje, e cila ka efektin e pakësimit të besimit të viktimave dhe qasjen e tyre në sistemin e drejtësisë penale.

V. Dhuna seksuale si formë e dhunës në bazë gjinore

Sipas Konventës së Stambollit, forma të tjera të dhunës me bazë gjinore që prekin gratë në mënyrë joproporcionale përfshijnë dhunimin seksual, sulmet seksuale, ngacmimet seksuale dhe format e tjera të dhunës seksuale.[161] Në Kosovë, vëmendje e konsiderueshme u është kushtuar viktimave të dhunës seksuale në konflikt gjatë viteve të fundit.[162] Ky kapitull përqendrohet vetëm tek viktimat e dhunës seksuale, përfshirë dhunimin seksual, si krime që nuk lidhen me konfliktin. Të dhënat e marra nga Policia e Kosovës theksojnë se janë raportuar vetëm 3 raste të dhunimit seksual në 2017, 7 në 2016 dhe 5 në 2015. (Shih tabelën 4)

Tabela 4.Rastet e raportuara ne Polici te Degradimit Seksual			
Viti	2015	2016	2017
Dhunim seksual	5	7	3
Sulm seksual	17	12	7
Degradim i integritetit seksual	2	0	1
Abuzim seksual i personave me aftësi të kufizuara mentale apo fizike	1	3	0
Abuzim seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetëvjecare(16)	36	35	26
Abuzim seksual duke përdorur pozitën,autoritetin apo profesionin	1	0	0

[161] Supra Note 2.
[162]Deri në vitin 2017, 17 vjet pas përfundimit të luftës, janë krijuar një Komision dhe Programi i Pensionit për ata viktima dhe të mbijetuarit.

Raportimi i dhunës seksuale mbetet shumë i ulët. Disa faktorë vazhdojnë të kontribuojnë në këtë nën-raportim, duke përfshirë frikën nga stigmatizimi (pasi dhunimi është një temë tabu në Kosovë), fajesimi i viktimës nga shoqëria, si dhe pajtim financiar midis familjeve, me ose pa dijeninë e institucioneve përgjegjëse.[163]

Ngacmimi seksual konsiderohet gjithashtu një formë e dhunës me bazë gjinore nga Konventa e Stambollit. Në Konventë, ngacmimi seksual përkufizohet si "çdo formë e sjelljes së padëshiruar verbale, jo verbale ose fizike të një natyre seksuale me qëllim ose efekt të shkeljes së dinjitetit të një personi, në veçanti kur krijon një ambient frikësues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues. "[164] Ngacmimi seksual mbetet i përhapur në Kosovë, me rreth 64% të grave që raportojnë se kanë përjetuar ndonjë formë të ngacmimeve seksuale gjatë jetës së tyre.[165] Qëndrimet për fajësimin e viktimave vazhdojnë të jenë të përhapura në Kosovë, siç ilustrohet nga fakti se 74% e njerëzve besojnë se ngacmimi seksual është një faj i gruas për shkak të mënyrës se si ajo vesh apo vepron.[166]

a) Mangësitë në legjislacionin ekzistues

Kapitulli XX i Kodit Penal të Republikës së Kosovës mbulon "veprat penale kundër integritetit seksual".[167] Kodi specifikisht përcakton dhunimin seksual, sulmet seksuale, ndalimin e blerjes së shërbimeve seksuale nga një viktimë e trafikimit, degradimin e integritetit seksual të personave etj.[168] Më tej, Kodi Penal pranon në një farë mase natyrën specifike gjinore të këtyre krimeve, edhe pse përcakton viktimat e cenueshme në kuptimin më të gjerë si persona që janë fëmijë, gra shtatzëna, partnerë familjar, persona me aftësi të zvogëluar dhe persona me aftësi të kufizuara fizike ose mendore (duke e cilësuar këtë si një rrethanë rënduese në një numër të krimeve që lidhen me integritetin seksual).[169] Më tej, Kodi nuk jep një përkufizim specifik të dhunimit seksual brenda martesës. Sipas Konventës së Stambollit, dhuna seksuale dhe dhunimi seksual midis partnereve/bashkëshortëve është gjithashtu një formë e ushtrimit të pushtetit dhe

[163]Intervistat e KIPRED-it me aktivistët e të drejtave të grave, avokatët dhe ekspertët mjeko-ligjorë, korrik, gusht dhe shtator 2018. Shihni Supra Note 8 dhe Supra Note 10
[164] Supra Note 2.Neni 30
[165] Supra Note 10
[166] Ibid.
[167] Supra Note 42. Kapitulli XX
[168]Akte të tjera të përcaktuara janë: Abuzimi seksual i personave me aftësi të kufizuara mendore ose emocionale, abuzimi seksual i të miturve, nxitja e akteve seksuale, ofrimi i materialeve pornografike për të miturit, abuzimi i fëmijëve në pornografi, keqtrajtimi seksual i pozitës së autoritetit martesa, prostitucioni lehtësues ose imponues, ofrimi i lokaleve për prostitucion dhe incesti Shih Kodin Penal të Kosovës, Kapitulli XX, Nenet 230 - 243.
[169]Shih për shembull nenin 230, paragrafi 4.7 dhe 4.8 të Kodit Penal të Kosovës.

kontrollit të partnerit abuziv mbi viktimën. Këto forma të dhunës do të ndodhin gjatë dhe pas ndërprerjeve. Prandaj, kriminalizimi dhe ndjekja e akteve të tilla kur kryhen kundër ish-partnerëve ose bashkëshortëve të tanishëm ose të mëparshëm duhet të njihen me ligj.[170] Edhe pse Kodi Penal i Kosovës i referohet marrëdhënies familjare si një rrethanë rënduese në rastet e dhunimit, ai kriminalizon vetëm sjelljen kundër anëtarëve të familjes ndërmjet moshës 16 dhe 18 vjeç. Ajo mbetet e heshtur në çështjen e dhunimeve të partnerëve familjar mbi 18 vjeç.[171]Kodi i ri penal në amandamentim e sipër ka adresuar edhe këtë çështje.

Ngacmimi seksual nuk është përcaktuar në mënyrë specifike në Kodin Penal. Neni 186 përfshin dispozitat e "Ngacmimit", por nuk parashikon një përkufizim specifik të ngacmimit seksual. Kjo ka çuar në faktin se institucione të ndryshme gjyqësore nuk mbajnë të dhëna për rastet e ngacmimit seksual.[172] Meqenëse Kodi Penal po ndryshohet aktualisht, ka nisma të udhëhequra nga shoqëria civile dhe aktivistët për të përfshirë ngacmimet seksuale në Kodin e ri Penal.[173]

Sipas standardeve ekzistuese ndërkombëtare për asistimin e viktimave të dhunës seksuale përfshirë viktimat e dhunimit, Konventa e Stambollit kërkon që palët shtetërore të kryejnë në mënyrë efektive hetimin dhe ndjekjen e të gjitha rasteve.[174] Kjo përfshin mbledhjen e të gjitha fakteve, intervistimin e të gjithë dëshmitarëve përkatës dhe përfundimin e testeve mjeko-ligjore.[175]

Rrjedhimisht, përdorimi i një përgjigje të koordinuar mirë institucionale konsiderohet standarde në trajtimin e natyrës së ndjeshme të rasteve të sulmeve seksuale (në veçanti rastet e dhunimit). Edhe pse Kosova ka procedurat standarde të veprimit për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje dhe personave të trafikimit, Kosova aktualisht nuk ka procedura ndërinstitucionale të Operimit Standard (SOP's) për të trajtuar rastet e dhunimit dhe sulmit seksual. Veprimet koordinuese ndërmjet institucioneve janë shumë të rëndësishme për të trajtuar siç duhet rastet e dhunimit dhe sulmit.[176] Policia duhet të jetë në gjendje t'u referojë viktimave shërbimeve të

---

[170]Supra Note 42. faqe 33

[171]Për dhunimin në marrëdhëniet familjare shih nenin 230, paragrafi 4.8. Marrëdhënia familjare përcaktohet sipas nenit 120, paragrafi 23 i Kodit Penal të Kosovës si "Marrëdhënia ndërmjet dy (2) personave: 23.1. të cilët janë të angazhuar ose të martuar me njëri-tjetrin ose bashkëjetojnë me njëri-tjetrin pa martesë; 23.2. të cilët ndajnë një familje kryesore të përbashkët dhe që janë të lidhur me gjak, martesë ose adoptim ose janë në një marrëdhënie kujdestarie, duke përfshirë prindërit, 57 gjyshërit, fëmijët, nipërit, motrat, hallat, xhaxhallarët, nipat, nipërit dhe kushërinjtë; ose 23.3. të cilët janë prindërit e një fëmije të përbashkët. "Në dispozicion në http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Criminal%20Code.pdf.

[172]Korrespondenca e KIPRED-it me Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës, korrik dhe gusht 2018

[173]Zyra e Kryeministrit të Kosovës, "Programi Legjislativ 2018", 2018, në www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2018,.pdf

[174]Supra Note 2. Faqe 43

[175] Ibid.

[176]Supra Note 2. Faqe 21

specializuara që do të mbështesin viktimën dhe të kryejnë mbledhjen në kohë të dëshmive të mjekësisë ligjore dhe të mbështesin viktimën për qasje në shërbimet gjyqësore.[177]

Procedurat Standarde të Veprimit për krimet e dhunimit dhe sulmet seksuale do të përcaktojnë në detaje rolet dhe përgjegjësitë e çdo autoriteti të përfshirë në hetimin,reagimin dhe ndjekjen penale të krimeve të dhunimit seksual dhe sulmeve seksuale. Në përgjithësi, KIPRED ka vërejtur se mungesa e procedurave specifike të operimit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Policinë e Kosovës dhe shërbimeve të prokurorisë shpesh çon në mungesë të koordinimit dhe njohurive mbi mënyrën e reagimit të menjëhershëm dhe efektiv të rasteve të dhunimit dhe sulmit seksual. Pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe të shërbimeve të prokurorisë nuk kanë marrë trajnime të mjaftueshme në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të dhunimit, duke i sjellë shpesh viktimat tepër vonë për mjekët e mjekësisë ligjore për mbledhjen e provave mjekësore.[178] Kjo shpesh çon në humbjen e provave të vlefshme mjekësore për të vërtetuar rastin në gjykata.[179]

Për më tepër, legjislacioni i Kosovës nuk parasheh krijimin e Qendrave për Dhunime Seksuale (QDHS) ose Qendrave Referuese Seksuale (QRS).[180] Standardet minimale në Evropë kerkojnë të jetë një QDHS për 400,000 gra dhe një QRS për 200,000 gra.[181] Qendrat e krizave të dhunimit seksual dhe qendrat e referimit për rastet e dhunës seksuale shërbejnë për qëllime të ndryshme, por të ndërlidhura. Qendrat e krizave të dhunimit seksual ofrojnë mbështetje afatgjate ndaj viktimave duke u angazhuar në avokim dhe ngritjen e vetëdijes për të parandaluar dhunën seksuale. Qendrat e tilla gjithashtu mund të ofrojë ndihmë dhe këshillim dhe të punojnë drejtpërdrejt me të mbijetuarit që mund të zgjedhin të mos e raportojnë krimin në polici.[182] Qendrat e referimit seksual, nga ana tjetër, punojnë për të përmirësuar reagimin mjeko-ligjor ndaj rasteve të dhunës seksuale, duke përfshirë dhunimin seksual dhe sulmet. Ata punojnë me të mbijetuarit që janë sulmuar kohët e fundit, ofrojnë këshillime afatshkurtra në raste të caktuara duke ofruar ndërhyrje në krizë, ekzaminim mjekësor dhe kujdes si dhe ndjekje të rasteve. Në disa qendra të referimit seksual, ato gjithashtu ruajnë dëshmi në rast se viktima vendos të raportojë krimin më vonë. Mungesa e këtyre qendrave në Kosovë ka çuar në shumë probleme lidhur me

[177] Ibid.
[178]Intervistë e KIPRED me Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Korrik 2018
[179]Intervistë e KIPRED me Organizatat e shoqerise civile te grave dhe Departamentin e Mjekësisë Ligjore, korrik dhe gusht 2018.
[180] Supra Note 35. Faqe 32
[181] Ibid.
[182]Supra Shenim 35

reagimin institucional lidhur me viktimat e dhunës seksuale, duke përfshirë një reagim joadekuat të institucioneve gjyqësore.[183]

Është pranuar se këto shërbime ofrohen më mirë nga organizatat e grave që kanë njohuri dhe përvojë në dhunën në bazë gjinore.[184]

Në përgjithësi, legjislacioni i Kosovës ka shumë mangësi kur bëhet fjalë për dhunën seksuale. Së pari dhe më kryesorja, Kodit Penal i mungon një përkufizim specifik i dhunimit seksual martesor dhe ngacmimit seksual, gjë që mund të çojë në ndjekjen dhe sanksionimin joadekuat të këtyre krimeve. Për më tepër, nuk ka PSV për krimet që kanë të bëjnë me dhunën seksuale, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë jep qasjen e pakoordinuar nga institucionet relevante. Së fundmi, Kosovës i mungojnë institucionet e specializuara, siç janë qendrat e krizave të dhunës seksuale dhe qendrat e referimit seksual.

c) Raportimi i rasteve lidhur me Dhunën Seksuale

Është e rëndësishme që viktimat e dhunimit seksual dhe sulmit seksual të marrin shërbime mbështetëse të menjëhershme, si dhe këshillime. Një përgjigje e duhur dhe e menjëhershme mund të shmangë ri-traumatizimin dhe të sigurojë që të gjitha dëshmitë forenzike të ruhen për të siguruar një proces të duhur hetimor. Duke marrë parasysh mungesën e Qendrave të Krimit të Dhunimit në Kosovë, pika e parë e kontaktit për viktimat e dhunimit seksual dhe sulmeve që dëshirojnë të raportojnë krimin është Policia e Kosovës. Policia vazhdon të mos jetë e trajnuar në mënyrë të duhur për të trajtuar raste të tilla, veçanërisht kur është fjala për të qenë të ndjeshëm, për të shmangur ri-traumatizimin dhe për ruajtjen dhe përdorimin e provave mjeko-ligjore.[185] Ka raste kur oficerët e policisë kanë fajësuar viktimën, duke i kërkuar viktimës se pse ajo ishte me kryesin vetëm në një orë të caktuar.[186] Një rast i vëzhguar nga Rrjeti Grave të Kosovës më 2016 ilustron më tej këtë qasje të fajësimit të viktimës. Viktima u pyet nëse ajo ishte e virgjër dhe nëse ajo kishte ndonjë kënaqësi apo orgazmë gjatë dhunimit.[187]Viktima duhej të përsëriste tregimin e saj në raste të shumta gjatë të njëjtës ditë, edhe pse ligjërisht, viktimave të dhunimit nuk duhet t'u kërkohet të përsërisin tregimin disa herë në mënyrë që të shmangin ri-traumatizimin.[188]

---

[183] Ibid.
[184]Ibid. Faqe 24
[185]Intervistat e KIPRED me Institutin për Mjekësi Ligjore dhe Prokurorë, Gusht dhe Shtator 2018
[186]Intervistë e KIPRED me përfaqësueste Rrjetit të Grave të Kosovës, Korrik 2018.
[187] Supra Note 5.
[188]Ibid.

Për më tepër, KIPRED-it i është bërë me dije gjatë monitorimit nga ana e përfaqësuesve të Departamentit të Mjekësisë Ligjore, se policia dhe prokurorët individualë kanë mungesë të trajnimeve dhe kapaciteteve për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive dhe të menjëhershme rasteve të raportuara të sulmeve seksuale dhe dhunimeve. Kjo është vërejtur në raste të shumta sipas Departamentit, ku viktimat u sollën me vonesa në departament pasi të gjitha të dëshmitë mjeko-ligjore dhe biologjike ishin zhdukur.[189]

Për shembull, policia ndoqi dhe arrestoi një grup njerëzish që vazhdimisht u raportuan se kishin dhunuar seksualisht një grua. Teknika hetuese u përdorën gjithashtu për të ndjekur rastin përmes operacioneve të fshehta. Megjithatë, vetëm pas gjashtë ditësh Policia e Kosovës e dërgoi atë për një ekzaminim në departamentin ligjor të Qendrës Klinike-Universitare të Kosovës. Përveç kësaj, Prokurori i Shtetit e solli viktimën në Departamentin për Mjekësi Ligjore pas 21 ditësh, duke pyetur nëse viktima ishte dhunuar seksualisht me të vërtetë. Siç thuhet, "*A e dhunuan gjithë pesë burrat, a e rrahën? Si duhet të jap këtë informacion pasi kanë kaluar shumë ditë* ?! "

Ka edhe raste kur viktima vendos të mos e raportojë krimin menjëherë pas incidentit për shkak të traumës. Në këto raste, viktima mund të lahet dhe dëshmitë forenzike të rëndësishme për hetimin dhe ndjekjen penale të krimit do të humbasin. Në këto raste, nëse dëshmitarët e syve mungojnë, atëherë hetimi efektiv dhe i menjëhershëm i krimit bëhet pothuajse i pamundur. Nëse Qendra e Krizave për Dhunim Seksual ka ekzistuar në Kosovë, viktimat do të kishin një strukturë të ndjeshme gjinore me profesionistë të trajnuar në dispozicion. Në disa qendra, viktimat kalojnë ne ekzaminim mjeko-ligjor dhe e kanë të ruajtur ekzaminim kur dëshirojnë ta raportojnë krimin. Dëshmitë tregojnë se mostrat e mjekësisë ligjore duhet të merren dhe të ruhen në mënyrë që viktima të vendosë më vonë nëse ata duan të raportojnë krimin apo jo.[190]

Aktualisht, vetëm një institucion kryen ekzaminime mjekësore për viktimat e dhunës seksuale, përfshirë dhunimin seksual dhe sulmet sekuale, përkatësisht Departamenti i Mjekësisë Ligjore.[191] Këto ekzaminime kryhen vetëm nëse ka kërkesë zyrtare për hetime nga shërbimet prokuroriale dhe nuk mund t'i qasen drejtpërdrejtë viktimat.[192] Për më tepër, mbledhja e provave të mjekësisë ligjore varet shumë nga reagimi në kohë. Aktualisht, vetëm Departamenti për Mjekësi Ligjore në Prishtinë mund të kryejë ekzaminime të tilla dhe transportimi i viktimave nga rajone të tjera në Prishtinë mund të çojë në humbjen e provave të vlefshme.[193] Vetëm një nga mjekët aktualisht të

[189]Intervistë e KIPRED me Departamentin e Mjekësisë Ligjore, Gusht 2018
[190] Supra Note 35. Faqe 26
[191]Intervistë e KIPRED me Prokurorin e Shtetit dhe Departamentin e Mjekësisë ligjore,Gusht dhe Shtator 2018.
[192] Supra Note 35. Faqe 33
[193] Ibid.

punësuar në Departamentin për Mjekësi Ligjore është grua.[194] Salla e intervistimit në këtë departament është e improvizuar dhe ndodhet në një korridor.[195]Këshillimi psikologjik nuk ofrohet gjatë dhe pas ekzaminimeve.[196] Megjithatë, kushtet e marrjes së ekzaminimit mjeko-ligjor janë të përshtatura sipas standardeve ndërkombëtare.

Në përgjithësi, viktimat përballen me disa vështirësi kur bëhet fjalë për raportimin e krimeve të dhunës seksuale siç janë dhunimet dhe sulmet. Nuk ka shërbime të ndjeshme gjinore për viktimat e dhunës, ku ata mund të kërkojnë këshillime dhe t'u nënshtrohen testeve mjeko-ligjore. Policia shpeshherë reagon në mënyrë joadekuate dhe fajëson viktimat. Viktimat ndeshen menjëherë pas krimit me vendimin e ashpër nëse duan të raportojnë dhunën apo jo. Në rastet kur ata nuk duan të raportojnë menjëherë dhunën, nuk ka asnjë mënyrë për të ruajtur provat ligjore për më vonë.

d) Ndjekja dhe dënimi i rasteve të dhunimit

Sistemi prokurorial dhe gjyqësor i Kosovës nuk ofron prokurorë apo gjyqtarë të specializuar që merren me veprat penale që lidhen me dhunën seksuale.[197] Të dhënat e dërguara nga institucionet nuk janë të plota dhe janë të vështira për t'u kuptuar për shkak të mekanizmave të ndryshëm të ndjekjes që përdoren në të gjitha institucionet gjyqësore. Për shembull, aktualisht nuk është e mundur të gjurmohet numri i rasteve të dhunimit dhe sulmit seksual të raportuara në polici, të hetuara nga prokuroria dhe të gjykuara në gjykata. Derisa Policia e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i mbajnë të dhënat veçmas për dhunimet dhe shkeljet e tjera, Këshilli Prokurorial i raporton të gjitha të dhënat së bashku në seksionin "Krimet kundër Integritetit Seksual".[198]

Kjo e bën të vështirë ndjekjen e rasteve të dhunimit dhe sulmeve veç e veç (Shih Tabelën 5). Megjithatë, të dhënat e prokurorisë tregojnë se në vitin 2016, vetëm 19% e të gjitha krimeve kundër integritetit seksual shkuan në paraburgim (31 raste nga 160 numri i përgjithshëm i aktakuzave në fillim të vitit). Në 2017, vetëm 23% e rasteve çuan në paraburgim nga 109 aktakuza të përgjithshme (26 nga 109). Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018, ka pasur 190 raste aktakuza penale dhe vetëm 5% e rasteve kanë shkuar në paraburgim. Për më tepër, të dhënat e prokurorisë nuk ofrojnë një ndarje gjinore të viktimave apo të sulmuesit. Për shkak të mungesës së një përkufizimi specifik të "Ngacmimit seksual" në Kodin Penal, të gjitha rastet në

[194]Rrjeti i Grave te Kosoves. Analiza Gjinore e Kosovës,2018, ne: www.womensnetwork.org/documents/20181003125154894.pdf
[195]Monitorim i KIPRED i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, Gusht 2018
[196] Ibid.
[197]Intervistë e KIPRED me prokurorë, Gusht dhe Shtator 2018
[198]Korrespodencë e KIPRED me Këshillin Prokurorial, Shtator 2018.

Tabela 5/Aktakuzat penale kundër Integritetit Seksual				
Viti	2015	2016	2017	2018
Numri i përgjithshëm i aktakuzave penale në fillim të periudhës së raportimit	141	160	109	190
Numri i investigimeve të pazgjidhura në fillim të periudhës së raportimit				
Kërkesa për denim	32	31	26	11
Lirim nga aktakuzat penale	12	28	22	21
Padi direkte	10	8	18	0
Vendim për inicim të investigimit	118	159	140	52
Aktakuza pas procedurës hetimore	90	137	100	48
Ndërprerja e procedurës për shkak të afatit ligjor të parashkruar	0	0	1	0
Propozimi për të vendosur masa të detyrueshme të trajtimit	1	0	0	0

shërbimet gjyqësore gjurmohen vetëm si raste "ngacmimi," duke e bërë të vështirë të dallohen midis ngacmimeve seksuale dhe rasteve të tjera të ngacmimit.

Numri i rasteve të liruara është gjithashtu shumë i lartë. Në vitin 2016, 17.5% e rasteve u liruan nga 160 raste të akuzuara. Në vitin 2017, janë liruar 20% të rasteve nga 109 raste të akuzuar penalisht dhe në gjashtë muajt e parë të vitit 2018, 11% të rasteve janë liruar nga 190 aktakuza penale. Prokurorët deklaruan KIPRED-in se është e vështirë të vërtetohet një çështje në gjykatë për shkak të mungesës së provave të forenzikës, si dhe faktit që gjykatat rregullisht nuk lëshojnë aktgjykime bazuar vetëm në deklaratën e viktimës.[199]

Një faktor tjetër për mbledhjen e dobët të dëshmive të mjekësisë ligjore lidhur me dhunimin dhe rastet e sulmeve seksuale është raportimi i vonuar nga vetë viktimat e krimit.[200]

Për shembull, prokuroria në Prizren raportoi hetimin e një rasti lidhur me dhunimin seksual te një fëmije 5 vjeçar, në të cilin dëshmia e vetme e fortë ishte deklarata e vetë viktimës pesëvjeçare. Megjithëse viktima përdorte gjuhë dhe referenca që nuk njiheshin nga një pesëvjeçar, Gjykata liroi rastin për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme të siguruara nga prokuroria.

[199]Intervistë e KIPRED me prokurorë, Gusht 2018.
[200]Intervistat me disa përfaqësues të shërbimit prokurorial, gusht dhe shtator 2018.

Në përgjithësi, ekziston një mungesë e gjerë e ndërgjegjësimit të viktimave se si të raportojnë dhunimet në mënyrë që të ruhen dëshmitë e mjekësisë ligjore.[201] Sidoqoftë, hetimet për rastet e dhunimeve dhe sulmit seksual duhet të jenë prioritet nga prokurorët, në mënyrë që të shmanget humbja e dëshmive të mjekësisë ligjore. Kjo mungesë prioritizimi është një nga faktorët që kontribuojnë në hetimin në kohë dhe mbledhjen e dëshmive të mjekësisë ligjore.[202] Për më tepër, procesi i grumbullimit të dëshmive shpesh përqendrohet në deklaratën e viktimës.[203] Dëshmitë e tjera si analiza e vendit të krimit, përdorimi i deklaratave të dëshmitarëve të mëparshëm dhe prova të tjera duhet gjithashtu të priorizohen.

Në sistemin gjyqësor, rastet e dhunimeve dhe sulmeve seksuale vazhdojnë të trajtohen dobët gjithashtu. Në vitin 2017, kishte nëntë raste të sulmit seksual të dënuar me gjoba dhe në gjysmën e parë të vitit 2018, u dënuan 8 raste të sulmeve seksuale (shih tabelën 6). Në vitin 2017, pesë raste të sulmit seksual u dënuan me kusht. Faktorë të tjerë janë në lojë për trajtimin joefektiv të krimit të sulmit seksual nga gjyqësori i Kosovës. Në disa raste, gjyqtarët fajesojne viktimën. Këto vëzhgime të njëanshme ndaj viktimave përdoren si rrethana lehtësuese për sulmuesit që të marrin dënime më të ulëta, siç janë gjobat dhe dënimet e kushtëzuara. [204] Faji vendoset ndaj viktimës nga gjykata pasi viktimat konsiderohen si "provokues" për sulmuesin.[205] Siç tha një i intervistuar, "gjykatat duhet të kenë arsye të forta për rrethanat lehtësuese dhe përveç të fajësimit të viktimave arsye tjera janë shumë të vështirë për tu gjetur në rastet e dhunimeve".[206]Këso deklarata mbi fajësimin e viktimave u konfirmuan nga një vendim gjyqësor që ka ardhur në vëmendje të ekipit hulumtues.

[201]Intervistë e KIPRED me prokurorët dhe Organizatat e shoqerise civile te grave, Korrik dhe Gusht 2018
[202]Intervistë e KIPRED me prokurorët, gusht dhe shtator 2018
[203]Supra Note 8 and KIPRED intervistat me prokurorët,Shtator 2018.
[204]Intervistë e KIPRED me prokurorë,Shtator 2018
[205] Ibid.
[206] Supra Note 196

Tabela 6. Rastet e Sulmeve Seksuale të dënuara nga Gjykatat						
Aktakuzat mbi Sulmet Seksuale				Rastet e dhunimeve		
Viti	2016	2017	2018	2016	2017	2018
Numri total	28	33	18	19	30	4
Paraburgim/Dënim me burgim	6	6	2	8	9	2
Dënim me gjobë	4	9	8	0	2	0
Dënim me kusht	5	5	3	3	5	0
Dënime tjera	1	0	0	1	0	0
Me aktgjykim lirues	1	3	1	2	4	2
Me aktgjykim refuzues	3	4	1	1	4	0
Rastet e parashkruara	0	4	2	2	1	0
Të vendosura ndryshe	8	2	1	2	5	0

Studimi i rastit: Vendim gjyqësor në rastin e dhunimit

Një vendim gjyqësor për një rast të dhunimit përfshinte aktakuzën nga shërbimet e prokurorisë në vitin 2017 për dy persona të raportuar nga viktima dhe të dyshuar se kishin dhunuar seksualisht një grua 19-vjeçare në një dhomë moteli.[207] Të dy të akuzuarit u liruan dhe gjykata deklaroj se nuk kishte prova të mjaftueshme për të provuar se dhunimi seksual ka ndodhur. Vendimi i gjykatës paraqet shumë aspekte të fajësimit të viktimës, duke portretizuar veprimet dhe vendimet e viktimës si arsye për dhunim. Ndër të tjera, vendimi thekson se "viktima, si një grua 19 vjeçare ra dakord të udhëtojë me makinë me shoferin mashkull, pa dhënë një destinacion të qartë për shoferin dhe duke ditur se shoferi ishte i martuar". Vendimi më tej thotë se, "viktima u pajtua me lehtësi të shkonte në një vend me të akuzuarit që ishin po aq të rinj sa ajo. Duke qenë në një hapësirë të mbyllur me të rinjtë, do të thotë drejtpërdrejt që viktima ra dakord të angazhohet në aventura seksuale." Vendimi i gjykatës thekson se "duke mos refuzuar të jetë në atë hapësirë me të akuzuarin, viktima në heshtje pranoi të kishte marrëdhënie seksuale me ta."

Një i intervistuar tjetër deklaroi se edhe pse rastet duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare, në disa raste prokurorët dhe gjyqtarët ndikohen nga qëndrimi i viktimës që vendos të mos vazhdojë më me procesin. Më tej, përkufizimi i pëlqimit nga viktima interpretohet gabimisht nga zyrtarët. Shumë prokurorë, gjyqtarë dhe policë nuk janë në dijeni se mungesa e pëlqimit përputhet me rastet e dhunimit. Në fakt, ata ende besojnë se viktima duhet të rezistojë (bërtas, të kërkojë ndihmë, të rezistojë fizikisht etj, në mënyrë që një veprim seksual të kualifikohet si vepër

[207]Vendimi i Gjykatës Themelore të Gjilanit, Vendimi #PKR. Nr200 / 2014 Vendosi në korrik 2017.

penale.[208] Kjo u konfirmua gjatë një interviste me një polic, i cili deklaroi në një intervistë me KIPRED se "nëse marrëdhënia nuk ishte e dhunshme, nuk është dhunim seksual".[209]

Ky seksion ka treguar reagimin e ngadaltë dhe joadekuat të institucioneve ndaj viktimave të dhunës seksuale. Viktimat e dhunës seksuale përballen me disa vështirësi në sistemin e drejtësisë, duke përfshirë qëndrimet ku fajësohen viktimat dhe ri-viktimizimin e përgjithshëm gjatë gjithë procesit. Numri i rasteve të liruara të dhunimeve dhe atyre që kanë marrë gjoba si dënim mbetet alarmante. Ngjashëm, shkalla e rasteve që marrin dënime me kusht mbetet e lartë.

V. Dhuna ndaj personave LGBT

Më 11 tetor 2017, Kosova shënoi një moment historik për respektimin e lirisë së shprehjes së komunitetit LGBT kur mbajti paradën e parë të suksesshme të krenarisë në qendër të Prishtinës. Sidoqoftë, shumë prej atyre që morën pjesë, që në fakt identifikohen si persona LGBT, kishin fytyrat e tyre të mbuluara mirë me qëllim që të fshehnin identitetet e tyre.[210] Frika nga kundërshtimet homofobike dhe dhuna nga familja, miqtë madje edhe të huajt,[211] si dhe presioni nga normat socio-kulturore që çojnë individët LGBT të fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Hulumtimet kanë treguar se më shumë se gjysma e të anketuarve kanë frikë të diskutojnë orientimin e tyre seksual me familjet e tyre.[212] Individët LGBT jo vetëm që kanë frikë nga kërcënimet e dhuna fizike nga shoqëria, por shpesh edhe kanë frikë nga abuzimi nga familjet e tyre. Në vitin 3023, 13% e të anketuarve LGBT në hulumtimin e YIHR u përgjigjën se kanë përjetuar abuzim verbal dhe janë larguar nga familjet e tyre.[213] Nuk ka studime të thella mbi qasjen në drejtësi për viktimat e krimit LGBT në Kosovë.[214]

a) Problemet me ligjet ekzistuese

[208]Intervistë e KIPRED me Prokurorinë, Shtator 2018
[209]Intervistë e KIPRED me Policë,Shtator 2018
[210]Halili, Dafina për Kosovo 2.0, "Balkan Unity in the Pride Parade", 2017, në: kosovotwopointzero.com/en/balkan-unity-pride-parade/
[211]Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore, "Liria dhe Mbrojtja e personave Gej, Lezbike, Biseksual, dhe Transgjinor në Kosvë, 2013, në:ks.yihr.org/public/fck_files/ksfile/LGBT%20report/Freedom%20and%20Protection%20for%20LGBT%20in%20Kosovo.pdf
[212]Ibid.
[213]Hulumtimi i përgjithshëm i kryer në vitin 2013 përfshinte 308 pjesëmarrës, duke përfshirë 88 persona LGBT, 17 gjyqtarë, 8 prokurorë, 17 avokatë, 30 oficerë policie, 59 zyrtarë të të drejtave të njeriut në nivel qendror dhe lokal dhe 89 profesionistë mjekësorë. Përqindja e cituar më sipër rrjedh nga 88 personat LGBT të intervistuar.
[214]Intervistë paraprake e KIPRED me organizatën LGBTI në Kosovë, maj 2018.

Diskriminimi i bazuar në orientimin seksual të një individi është i ndaluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.[215] Me përjashtim të Kosovës, vetëm nëntë nga 193 vende anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe vetëm tre vende të tjera evropiane kanë ndalime kushtetuese të diskriminimit të bazuar në orientimin seksual.[216] Më konkretisht, Ligji i Kosovës për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon diskriminimin e bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.[217] Më tej, diskriminimi i bazuar në identitetin gjinor është gjithashtu i ndaluar nga Ligji për Barazi Gjinore.[218]

